

Vlerësimi i rrezikut nga *zjarri* në muzetë e Kosovës

CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
KOSOVO



Vlerësimi i rrezikut nga zjarri
në Muzetë e Kosovës

Autorë:

Charlotte Fafet
Erinë Mulolli Zajmi

Prishtinë
Prill, 2019



Përmbajtja

■ Hyrje	7
■ Qëllimi i studimit	8
■ Metodologjia	8
■ Kapitulli 1: Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë për të mbrojtur trashëgiminë kulturore	10
■ Pse duhet të studiohen rreziqet të cilat ndikojnë në lokalitetet e trashëgimisë kulturore?	11
■ Cilat janë rreziqet të cilat mund të ndikojnë në lokalitetet e trashëgimisë kulturore?	11
■ Cilat janë rreziqet ndaj trashëgimisë kulturore në Kosovë?	20
■ Rreziqet	20
■ Kapitulli 1: Vërejtje përmblylëse	24
■ Kapitulli 2: Kërcënimi i muzeve nga zjarri	26
■ Specifikat në kontekstin e ndërtesave historike dhe muzeve	27
■ Burimet e zjarreve	27
■ Pasojat e zjarreve	27
■ Çfarë mund të bëjmë për të zvogëluar rrezikun nga zjarri?	28
■ Parandalimi i një zjarri	28
■ Zbutja: Zvogëlimi i pasojave të mundshme nga zjarri	28
■ Përgatitja e reagimit	29
■ Kapitulli 3: Vlerësimi i rrezikut nga zjarri në muzetë e Kosovës	32
■ Rezultatet	33
■ Prishtinë	34
■ Gjakovë	44
■ Gjakovë	50
■ Peja	58
■ Prizren	64
■ Ferizaj	80
■ Gjilan	86
■ Përmbledhja e rezultateve	100
■ Përfundimi dhe rekomandimet	102
■ Përfundimi i Raportit	106
■ Referencat	108
■ Aneks: Pyetëtori i përdorur gjatë intervistave	112



Zjarri është ndër rreziqet më të përsëritura që mund të prekin muzetë dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore. Pasojat e tyre mund të jenë shumë të rënda, me humbje të pakthyeshme.

Hyrje

Më 15 prill 2019, një zjarr i madh që kaploi katedralen “Notre Dame” në Paris la të djegur një pjesë të madhe të kulmit dhe kullën qendrore të saj. Zjarri filloi në atiken e Katedrales, dhe njëra ndër arsyet përse u përhap aq shpejt ishte sasia e madhe e drurit me të cilin ishte i konstruktuar kulmi. Shkaktari i këtij zjarri ende nuk dihet, ndërsa më shumë se 400 zjarrfikës ishin të angazhuar në shuarjen e tij. Sipas “New York Times”, Katedralja ishte e pajisur me sistemin për detektimin e tymit, por jo edhe me pajisje të tjera bazë, siç janë: spërkatësit e ujit apo muret rezistuese ndaj zjarrit, të cilat do ta ndalonin përhapjen e zjarrit.

Në anën tjetër, më 2 shtator të vitit 2018, një zjarr tjetër, që zgjati më shumë se dy orë, shkatërroi rreth 90% të koleksionit në Muzeun Nacional të Brazilit. Dëmtimet janë të mëdha. Në mesin e shumë artefakteve të vlefshme humbën edhe incizimet e fundit të mbetura të disa gjuhëve të cilat nuk fliten më. Kjo ngjarje është tragjike, sidomos për faktin se ka qenë e mundur të merreshin disa masa në mënyrë që të parandaloheshin pasojat. Sipas “New York Times”, Muzeu nuk ishte i pajisur me sistemin për fikjen e zjarrit, dhe ai përmbante shumë materiale ndezëse. Si rrjedhojë, ndërtesa ishte në rrezik të madh.

Zjarri është ndër rreziqet më të përsëritura që mund të prekin muzetë dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore. Pasojat e tyre mund të jenë shumë të rënda, me humbje të pakthyeshme. Në Kosovë janë bërë disa studime rreth rreziqeve që mund të ndikojnë (prekin) lokalitetet e trashëgimisë kulturore. Ky raport fillimisht vë në pah rreziqet e ndryshme që prekin lokalitetet e trashëgimisë kulturore në përgjithësi, para se të vendosen ato në kontekstin e Kosovës, në mënyrë që të mundë të identifikohen se cilat janë rreziqet më të përhapura të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Me zjarrin si njëri ndër rreziqet dominuese në Kosovë, pjesa e fundit e studimit ka në fokus vlerësimin e rrezikut ndaj zjarrit në disa muze të Kosovës. Ky vlerësim ndihmon në identifikimin dhe në prioritetet e disa masave që duhet të ndërmerren në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje më e mirë e muzeve dhe e koleksioneve të tyre në Kosovë.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i gjendjes ekzistuese të muzeve të Kosovës në kuptim të ekspozimit dhe të ndjeshmërisë ndaj zjarrit. Ky vlerësim do të ndihmojë për të definuar se cilat janë kapacitetet dhe dobësitë e muzeve të Kosovës për t'u përballur me rreziqet ndaj zjarrit. Identifikimi i qartë i asaj se çka mungon në muze do të ndihmojë në definimin e zgjidhjeve specifike të kontekstit, që do të përmirësojë aftësinë rikuperuese të muzeve të Kosovës dhe të koleksioneve të tyre në raste të zjarrit.

Metodologjia

Ky studim ka përdorur dy metoda të mbledhjes së informatave të gjendjes ekzistuese të muzeve të Kosovës; përmes pyetësorit dhe observimit në terren. Pyetësori përmban pyetje lidhur me aspektet kryesore të cilat kontribuojnë në rikuperimin e ndërtesës ose në ndjeshmërinë e ndërtesës ndaj zjarrit. Pyetësori i përdorur gjatë vizitave në terren është i bashkëngjitur në aneksin e këtij raporti. Ai ka përfshirë kategori dhe aspekte të shumta të organizuara në shtatë seksione, në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më gjithëpërfshirës.

Pjesa e parë e pyetësorit përmban disa pyetje bazike lidhur me ndërtesën, në mënyrë që të bëhet identifikimi dhe të jepen karakteristikat e saj. Pastaj pyetësori fokusohet në përshkrimin e hapësirës përreth ndërtesës. Në të vërtetë, është e rëndësishme mbledhja e këtyre informatave në mënyrë që të vlerësohet ekspozimi i muzeve ndaj zjarrit, i cili mund të ketë filluar jashtë ndërtesës. Po ashtu, është vrojtuar edhe prania e ndërtesave ndërhyrëse, afërsia e infrastrukturës, sikurse janë kabllot elektrike ose afërsia e rrugës, si dhe pastërtia e rrethinës (meqë mbeturinat në tokë mund të jenë burim i zjarrit).

Pjesa e tretë e pyetësorit fokusohet në ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën brenda ndërtesës. Është e rëndësishme të dihet nëse në të kaluarën ka pasur zjarr në ndërtesë, si dhe të kemi informata se cilat ishin humbjet apo cili ishte burimi i zjarrit (nëse dihet). Kjo mund të na jep detaje të rëndësishme rreth ndjeshmërisë së muzeve ndaj zjarreve.

Pjesa e katërt e pyetësorit fokusohet në menaxhmentin e muzeve. Problemet menaxheriale mund të shpjegojnë mungesën e zbatimit të masave kundër zjarrit ose ndjeshmërisë ndaj zjarrvënieve (si p.sh. komunikimi jo i mirë ndërmjet stafit mund të çojë në organizim dhe koordinim jo të duhur në raste të fatkeqësive dhe kështu të rrisë pasojat nga zjarri).

Pjesa e pestë fokusohet në aspektin fizik të ndërtesës, sikurse janë materialet



Është vlerësuar, po ashtu, edhe mirëmbajtja e ndërtesës, meqë mirëmbajtja dhe inspektimi i rregullt i ndërtesës mund të ndihmojnë në identifikimin e burimeve potenciale të zjarrit dhe të zvogëlojnë rreziqet nga zjarret aksidentale

ndërtimore ose identifikimi i rreziqeve potenciale të ndezjes brenda ndërtesës (sikurse qirinjtë ose sistemet e vjetra të rrymës). Është e rëndësishme mbledhja e këtyre informatave, në mënyrë që të analizohet nëse ka burime potenciale të zjarrit në ndërtesë. Po ashtu, është vlerësuar edhe qasja e ndërtesës: ky është ndër aspektet kryesore, meqë një qasje e mirë në ndërtesë mund të lehtësojë punën e zjarrfikësve dhe të sigurojë që intervenimi të jetë në kohë dhe mënyrë të duhur. Pyetësi, po ashtu, ka përmbajtur edhe ekzistencën e sistemeve të sigurisë nga zjarri dhe të pajisjeve, të evakuimit dhe planeve emergjente, si dhe të trajnimit të stafit për raste emergjente.

Një pjesë tjetër e pyetësit fokusohet në aspektin e sigurisë së ndërtesës. Në të vërtetë, siguria e mirë e ndërtesës zvogëlon ndjeshmërinë ndaj zjarrvënies së qëllimshme. Është vlerësuar, po ashtu, edhe mirëmbajtja e ndërtesës, meqë mirëmbajtja dhe inspektimi i rregullt i ndërtesës mund të ndihmojnë në identifikimin e burimeve potenciale të zjarrit dhe të zvogëlojnë rreziqet nga zjarret aksidentale (për shembull për shkak të defekteve elektrike).

Aspekti i fundit i cili është vlerësuar përmes pyetësit ishte edhe koleksionet e muzeve. Është pyetur se si janë dokumentuar dhe shënuar (etiketuar) koleksionet. Në rast të zjarrit dhe në rast të humbjes së artefakteve, është shumë e rëndësishme të ketë një bazë të të dhënash ose dokumente, në mënyrë që të identifikohen humbjet dhe të zvogëlohet rreziku i humbjes së informatave rreth koleksioneve. Në këtë mënyrë rekomandohet të ketë baza të dhënash rezervë në forma të ndryshme (kopje të forta, baza të dhënash online etj.).

Pyetësi është përdorur gjatë vizitave në muze dhe pyetjet u janë bërë stafeve të tyre. Duke vepruar kështu, ishte më e lehtë të verifikoheshin pyetjen nga palët e interesit dhe të merreshin informatat e nevojshme në raste të caktuara. Ishte, po ashtu, interesante edhe studimi i reagimit të njerëzve ndaj temës. Disa pyetje të pyetësit janë plotësuar përmes observimeve të bëra gjatë vizitave. Gjithsej janë vizituar 13 muze.

Kufizim i kësaj metodologjie është se shpeshherë pyetjet u janë bërë vetëm një ose dy anëtarëve të stafit, kështu që përgjigjet ndonjëherë mund të pasqyrojnë këndvështrimin apo mendimin e vetëm një personi për situatën. Për më tepër, një person ndonjëherë mund të mos jetë në dijeni të disa masave për mbrojtjen nga zjarri, të pranishme nëpër muze.

1

Menaxhimi i
rrezikut nga
fatkeqësitë për
të mbrojtur
trashëgiminë
kulturore

Pse duhet të studohen rreziqet të cilat ndikojnë në lokalitetet e trashëgimisë kulturore?

Studimi i rreziqeve është shumë i rëndësishëm, në mënyrë që të gjenden masat e nevojshme të cilat mund të zvogëlojnë gjasat ose pasojat. Arsyeya e parë është mbrojtja e jetës së njerëzve, meqë lokalitetet e trashëgimisë kulturore zakonisht vizitohen nga shumë njerëz. Sido që të jetë, trashëgimia kulturore është e rëndësishme të mbrohet, meqë ajo, ndër të tjera, edhe kontribuon në zhvillimin social e ekonomik të një vendi. Për më tepër, ajo lidhet me historinë dhe traditat e një vendi, kështu ka edhe dimensionin simbolik. Trashëgimia kulturore po ashtu paraqet vlerat dhe identitetin e një komuniteti. Në këtë mënyrë, mbrojtja e trashëgimisë kulturore ndihmon në promovimin e ndjenjës së komunitetit duke rritur ndjenjën e përkatësisë.

Cilat janë rreziqet të cilat mund të ndikojnë në lokalitetet e trashëgimisë kulturore?

Lokalitetet e trashëgimisë kulturore janë të ekspozuara ndaj degradimit nga shkaqet natyrore dhe nga procese të ndryshme. Degradimi nga shkaqet natyrore çon në degradime kimike, fizike e biologjike të materialeve të ndërtesave dhe të përbërësve të tyre (duke përfshirë ndërtesat dhe artefaktet) të cilat konsiderohen si asete të trashëgimisë kulturore.

PROCESET E DEGRADIMIT NATYROR

Kushtet natyrore

- Lagështia
- Të ftohtit, të nxehtit
- Presioni i erës
- Karakteristikat e tokës (ujërat nëntokësore, kripa, etj)

Proceset natyrore

- Shkatërrimi natyror i materialeve (kalbja, korrozioni)
- Veprimet e insekteve dhe të vejetacionit
- Erozioni
- Fenomenet klimatike

Megjithatë, këto degradime mund të theksohen apo të përshpejtohen nga lloje të ndryshme të rreziqeve. Çdo vit shumë lokalitete të trashëgimisë kulturore shkatërrohen apo dëmtohen për shkak të rreziqeve natyrore apo njerëzore. Nga këto fatkeqësi natyrore nuk janë të prekura vetëm asetet e trashëgimisë natyrore, por edhe "mjeshtëritë tradicionale", shkathtësi e praktika (të tilla si artizanalet) të cilat në thelb lidhen me artefakte apo me prona të trashëgimisë kulturore.

Rreziqet janë mjaft komplekse për t'u kuptuar. Ato dallojnë nga rreziqet e papritura e deri në ato graduale (p.sh. vërshime të mëdha që vijnë papritmas ose degradimi kimik për shkak të lagështisë që është një proces gradual). Për më tepër, asetet e trashëgimisë kulturore mund të ndikohen nga rreziqet e shkallës së gjerë (p.sh. tërmetet) sikurse edhe rreziqet e shkallës së vogël (mikroshkallë) (p.sh. degradimi biologjik i shkaktuar nga insektet).

Veç kësaj, rreziqet janë të vështira për t'u kuptuar, sepse ato mund të kenë efekte të dukshme, por edhe efekte të padukshme në asete të trashëgimisë kulturore. Për shembull, ato mund të çojnë në rreziqe dytësore (një zjarr në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të shkatërrojë disa pjesë të një aseti, përderisa lëkundja e shkaktuar nga lagështia nga fikja e zjarrit mund të shkaktojë po ashtu dëme të mëdha në aset).

Tabela e paraqitur më poshtë përpiqet të identifikojë rreziqet e ndryshme të cilat mund të ndikojnë në asete të trashëgimisë kulturore dhe të jep disa ide të masave të cilat mund të zbatohen për t'u kundërvënë atyre rreziqeve. Për qëllimet e këtij hulumtimi janë marrë parasysh asetet e trashëgimisë kulturore dhe komponentët e tyre (përfshirë këtu koleksionet e muzeve)- ndërsa do të mundë të konsideroheshin edhe asete të tjera të trashëgimisë kulturore sikurse lokalitetet arkeologjike apo trashëgimia e paluajtshme.

1. REZIQET NATYRORE

1.1. Ngjarjet hidro-meteorologjike

Lëndët e djegshme	<p>Djegia e tërësishme apo e pjesshme e ndërtesës ose e komponentëve të saj</p> <p>Dëmtimi i strukturave, i enterierit dhe i objekteve si pasojë e tymit dhe e depozitimit të blözës</p> <p>Deformimi ose përkeqësimi (si pasojë e reaksioneve kimike) i disa materialeve- objekteve ose elementeve strukturore, si pasojë e temperaturave të mëdha</p> <p>Reduktimi i kapacitetit struktural të disa materialeve, ndonjëherë pa shenja të dukshme të përkeqësimit, si pasojë e temperaturës</p> <p>Degradimi lidhur me ujin si pasojë e fikjes së zjarrit (në afatgjatë kjo mund të çojë në lagështi apo në korrozion)</p>	<p>Qasja e lehtë në furnizimin me ujë (ato mund të vendosen në harta)- aparate për fikjen e zjarrit (manuale apo automatike)</p> <p>Detektorë të tymit</p> <p>Dalje emergjente (të evakuimit) + shenjat</p> <p>Ndriçimi automatik emergjent</p> <p>Pastrimi i ndërtesës nga mbeturinat</p> <p>Të sigurohet që instalimet elektrike, qarqet dhe pajisjet të testohen rregullisht, të mirëmbahen, të përdoren dhe të rishikohen siç duhet</p> <p>Zvogëlimi ose mbrojtja e materialeve të djegshme (ndërtimet e drurit, tepihët)- burimet e mundshme të djegies (ndezëse) brenda ndërtesës</p> <p>Lëndët e ndezshme: identifikimi i stinëve të djegies dhe implementimi i lejeve për ndalimin e djegies- zjarrit gjatë kësaj periudhe</p> <p>Kampanja vetëdijesuese, trajnimi i qytetarëve</p> <p>Planet e menaxhimit të zjarrit në bashkëpunim me stafin e brigadës së zjarrfikësve</p> <p>Lidhja e alarmit me departamentin e zjarrfikësve</p> <p>Përmirësimi i qasjes në lokalitet, në mënyrë që të lehtësohet lëvizja e automjetit për fikjen e zjarrit</p>
Përmytjet, reshjet e rënda (e mëdha)	<p>Rënia, deformimi, abrazioni, thyerja, plasaritja, dobësimi i ndërtesës ose komponentëve të tij për shkak të forcës së ujit</p> <p>Ndotja si rezultat i përzjerjes së sistemit të ujit dhe kanalizimit</p> <p>Lagështia dhe korrozioni për shkak të lagështisë së lartë</p>	<p>Përmirësimi i sistemit të drenazhit</p> <p>Shtimi i kolektorëve të ujit- stacionet e pompimit</p> <p>Pendët e ujit, digat</p> <p>Mirëmbajtja e shtratit të lumit</p> <p>Trajnime dhe kampanja të vetëdijesimit</p>

	<p>Dëmet e shkaktuara në infrastrukturë, të tilla si linjat elektrike</p> <p>Problemet e qasjes</p> <p>Paqëndrueshmëria e nëntokës</p> <p>Kristalizimi dhe shpërbërja e kripërave (kur thahen pas lagështisë) mund të ndikojnë në sipërfaqet e dekoruara sikurse janë pikturat e muritErozioni</p>	<p>Mbrojtja e kablove elektrike</p> <p>Sistemet e detektimit të hershëm (sikurse parashikimet e motit)</p> <p>Vlerësimi dhe sipas nevojës edhe përforcimi i themeleve të ndërtesës, strukturës dhe kulmit me qëllim të zvogëlimit të mundësisë së hyrjes së ujit dhe shkatërrimit të shkaktuar nga forca e ujit</p> <p>Përfundimisht, përdorimi i materialeve të reja dhe teknikave të përforcimit me qëllim të riparimit ose përmirësimit të rezistencës së ndërtesës nga përmytjet</p>
Stuhitë	Përkeqësimi i sipërfaqeve për shkak të erozionit	<p>Përforcimi i ndërtesës dhe i komponentëve të saj për të qenë më rezistues ndaj erës</p> <p>Monitorimi dhe kontrollimi, meqë shpeshherë përkeqësimi është një proces i ngadalshëm</p> <p>Kampanjat vetëdijesuese</p>
Thatësia	<p>Erozioni i ndërtesave ose i komponentëve të tyre</p> <p>Kristalizimi dhe shpërbërja e kripërave të shkaktuara nga luhatshmëria e lagështirës</p>	<p>Kampanjat vetëdijesuese</p> <p>Monitorimi dhe kontrollimi, meqë shpeshherë përkeqësimi është një proces i ngadalshëm</p> <p>Masat e duhura të përforcimit ose masat e ruajtjes/ konservimit të disa materialeve</p> <p>Përdorimi i termo-hygrometrit për të monitoruar nivelin e temperaturës dhe lagështinë relative</p> <p>Inspektimi i rregullt nga konservatorët për të zbuluar nivelin e përkeqësimit të shkaktuar nga faktorët mjedisorë</p>
Valët e nxehtësisë dhe periudhat e të ftohtit (temperaturat ekstreme meteorologjike)	Temperaturat jo të përshtatshme mund të shkaktojnë përkeqësimin e ndërtesës dhe komponentëve të saj përmes reaksionit kimik, deformimit, plasaritjes, dobësimin ose korrozionit	<p>Monitorimi i temperaturës së dhomës dhe shenjat e para të ndërtesës</p> <p>Kampanjat vetëdijesuese</p> <p>Masat e duhura të përforcimit ose masat e ruajtjes/ konservimit të disa materialeve</p> <p>Përdorimi i termo-hygrometrit për të monitoruar nivelin e temperaturës dhe lagështinë relative</p> <p>Inspektimi i rregullt nga konservatorët për të zbuluar nivelin e përkeqësimit të shkaktuar nga faktorët mjedisorë</p>

1.2. Ngjarjet gjeologjike

Tërmetet	Dëmet strukturore dhe rënia, deformimet, abrazioni i ndërtesës dhe i komponentëve të tij	Mikrozonimi sizmik (analizat e rrezikut)
	Reduktimi i stabilitetit të ndërtesës dhe rezistenca ndaj goditjeve të ardhshme	Konsolidimi i ndërtesave (duke ndjekur praktikatat e ndërtimeve të qëndrueshme ndaj tërmetit) për të riparuar ose përfunduar infrastrukturën.
	Qasje e vështirë në dhe nga lokaliteti	Mirëmbajtja është po ashtu e rëndësishme për të përmirësuar rezistencën ndaj tërmetit
		Reduktimi i ekspozimit ndaj linjave elektrike + mirëmbajtja
		Trajnime dhe kampanja vetëdijesuese (të stafit dhe komunitetit lokal)
Orteku, toka dhe rrëshqitjet e dheut dhe rrjedhat	Rënia, dobësimi, deformimi, abrazioni i ndërtesës ose i komponentëve të tij	Konsolidimi i shpateve kodrinore (për shembull duke shtuar pemë ose mure mbajtëse)
	Uji mund të shkaktojë lagështi, lulëzim të kripës, rritje biologjike dhe korrozion, thyerje dhe erozion të materialeve	Përmirësimi i sistemit të drenazhit Kontrollimi i përdorimit të tokës: ndalimi i qasjes në zonat me rrezikshmëri të lartë - kufizimi i ndërtimit në këto hapësira
		Sistemi i paralajmërimit të hershëm (përmes parashikimit të motit dhe studimeve, hulumtimeve gjeologjike)
		Drenazhimi i shpateve me qëllim të reduktimit të depërtimit të ujit
		Trajnime dhe kampanja vetëdijesuese (të stafit dhe komunitetit lokal)
		Përdorimi i termo-hygrometrit për të monitoruar nivelin e temperaturës dhe lagështinë relative
		Inspektimi i rregullt nga konservatorët për të zbuluar nivelin e përkeqësimit të shkaktuar nga faktorët mjedisorë
Shpërthimi i vullkanit	Shembja, deformimi, thyerja, abrazioni i ndërtesës ose i komponentëve të saj për shkak të forcave fizike, ndryshimeve në temperaturë dhe lagështi	Sistemi i paralajmërimit të hershëm
		Trajnimi dhe kampanja vetëdijesuese

1.3. Ngjarjet biologjike

Insektet dhe specie pushtuese	Përkeqësimi dhe dobësimi i disa materialeve (siç është shpimi)	Ndalimi i ushqimit në lokalitet
Speciet e zhvendosura		Monitorimi i temperaturës dhe lagështisë që mund të rritë shfaqjen e disa specieve
		Përdorimi i termo-hygomtrit për të monitoruar nivelin e temperaturës dhe lagështinë relative
		Inspektimi i rregullt nga konservatorët për të zbuluar nivelin e përkeqësimit të shkaktuar nga faktorët mjedisorë

2. RREZIQET E SHKAKTUARA NGA AKTIVITETET HUMANE

2.1. Aktet e dhunës	Shkatërrimi i tërësishëm ose i pjesshëm i ndërtesave ose koleksioneve	Sistemet e alarmit, kamerat dhe rojat për të parandaluar vjedhjet dhe vandalizmin
Konfliktet		
Terrorizmi	Dëmtimi i objekteve, koleksioneve, ndërtesave, për shkak të vandalizmit (sikurse grafitët) ose armët e luftës (bomba etj.)	Kopje rezervë të informatave rreth aseteve të trashëgimisë kulturore
Vandalizmi	Humbja e trashëgimisë për shkak të vandalizmit ose vjedhjes Humbja e informatave rreth aseteve të trashëgimisë kulturore Pamundësia e qasjes në gjësendet e trashëgimisë kulturore	Përdorimi i vitrinave të xhamit në muze me qëllim të parandalimit të vandalizmit dhe vjedhjes
2.2. Ndryshimi i përdorimit të tokës	Humbja e cilësisë estetike për shkak të ndërhyrjes së ndërtesave (ndërtesa të larta, qendra tregtare etj.)	“Buffer” zonat (zonat mbrojtëse) rreth aseteve të trashëgimisë kulturore; masat mbrojtëse përmes ligjeve
Transformimet urbane: Zgjerimi urban, zhvillimi i pakontrolluar urban	Demolimi i disa komponentave të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore	Kampanjat vetëdijesuese
Projektet e mëdha të zhvillimit: digat, operacionet e minierave dhe pylltarisë, infrastruktura e transportit	Paqëndrueshmëria e strukturë. Rritja e ndotjes, e cila mund të krijojë dobësim të strukturës, ndryshim të ngjyrës (zbehja e ngjyrës së ndërtesave ose nxirja e fasadave të ndërtesës), erozion, korrozion	
2.3. Aksidentet	Dëmtimi ose humbja e aseteve të trashëgimisë kulturore (thyerje, etj)	Përdorimi i vitrinave për të mbrojtur koleksionet në ekspozitat e muzeve
Dështimet infrastrukturore	Ndotja si rezultat i aksidenteve, e cila mund të përkeqësojë vetitë fizike të asetit, teksturat dhe përbërjen kimike të disa materialeve, sikurse janë gurët Ndotja mund të shkaktojë erozion, korrozion ose dobësim të strukturës, nxirjen e materialeve	Paketimi me materiale amortizuese në rast të transportimit të koleksionit
Aksidentet industriale-nukleare (rrjedhje, derdhje, shpërthim, zjarr)	Zjarri (që rezulton nga një aksident apo eksplozim) mund të shkaktojë dëmtime të rënda të strukturës ose ndërtesave	
Aksidentet “shtëpiake” (bartje, ruajtje ose transportim i gabuar)		

2.4. Turizmi- mbipopullimi	Vizitat e tepruara mund të çojnë në temperaturë dhe lagështi të gabuar dhe mund të përshpejtojnë përkeqësimin nga reaksionet kimike, si dhe mund të ndikojnë në dobësimin e strukturës, abrazionin, korrozionin dhe erozionin e materialeve	Ndalimi i "selfie sticks" në muze, me qëllim të shmangies së dëmtimeve aksidentale të veprave artistike
	Mbipopullimi mund të çojë në aksidente dhe në dëmtime të rënda	Përdorimi i vitrinave me qëllim të mbrojtjes së koleksioneve në muze Bllokimi i hyrjes së vizitorëve ose kufizimi i qasjes në zona të ndjeshme në asete - lokalitete Përdorimi i termo-hygrometrit për të monitoruar nivelin e temperaturës dhe lagështinë relative

3. RREZIQET MENAXHERIALE

3.1. Rreziqet e jashtme menaxheriale

Problemet e lidhura me politikat	Shkatërrimi i tërësishëm ose i pjesshëm i ndërtesave/ aseteve (braktisja e pronave)
Autoritetet konfliktuale, problemet pronësore dhe autorizimi	Mungesa e mirëmbajtjes dhe përkeqësimi i aseteve dhe i komponentëve të tyre
Strategjitë dhe prioritetet joadekuate (të papërshtatshme), burokracia joefikase	
Mungesa e interesit politik	
Mungesa e fondeve dhe investimeve	

Mangësitë e legjislacionit	Shkatërrimi i tërësishëm ose i pjesshëm i ndërtesave- aseteve (braktisja e pronave)
Përkufizimet e vjetruara	
Mungesa e masave të zbatimit - standardet e pamjaftueshme të konservimit	Mungesa e mirëmbajtjes dhe përkeqësimi i aseteve dhe i komponentëve të tyre
Detyrimet joreale	

3.2. Rreziqet e brendshme menaxheriale

Ekip joadekkuat (për shkak të mungesës së trajnimeve, njohurive të kufizuara)	Kjo mund të çojë në mirëmbajtje- përkujdesje të keqe (shih më lart), si dhe në mungesë të ndërgjegjësimit ose reagimit të duhur në raste emergjente (sikurse shpërthimi i rrezikut natyror)	Konsolidimi i ekipit
Kommunikim-bashkëpunim i dobët	kështu krijon dëmtime ose humbje të aseteve të trashëgimisë kulturore	
Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare		

4. RREZIQET E LIDHURA ME MIRËMBAJTJEN

<p>4.1. Pajisjet joadekuatë - kontrollimi i dobët i cilësisë së infrastrukturës dhe i pajisjeve (p.sh. drita, klimatizimi, burimi i ushqimit, instalimet e gabuara elektrike ose të pajisjeve)</p>	<p>Zbehja e ngjyrës, përkeqësim i shpejtë, deformimi, shpërbërja dhe dobësimi për shkak të ndriçimit joadekuat, insekteve, temperaturës dhe lagështisë joadekuatë</p> <p>Zjarri që mund të çojë në djegie të tërësishme ose të pjesshme dhe në dëmtime apo humbje të rënda të aseteve të trashëgimisë kulturore (objekte ose ndërtesa)</p>	<p>Bllokimi i rezeve direkte të diellit në zonat e ndjeshme të trashëgimisë kulturore përmes përdorimit të perdeve dhe filtrave në dritare</p> <p>Përdorimi i vitrinave për të mbrojtur koleksionet (sidomos në ekspozitat e muzeve)</p> <p>Përdorimi i termo-hygrometrit për të monitoruar nivelin e temperaturës dhe lagështinë relative</p>
<p>Lagështia relative, temperatura, ndriçimi dhe insektet e gabuara</p>	<p>Mungesa e kontrollimit të qasjes në infrastrukturë mund të çojë në vjedhje dhe në vandalizëm e që mund të dëmtojë strukturat ose koleksionet, apo të çojë në zhdukjen e tyre</p>	<p>Inspektimi i rregullt nga konservatorët për të zbuluar nivelin e përkeqësimit të shkaktuar nga faktorët mjedisorë</p>
<p>Lagështia relative, temperature, ndriçimi dhe insektet e gabuara</p>		
<p>4.2. Mungesa e monitorimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, mungesa e inventarit, dokumentimi ose identifikimi i dobët, "vjetërsimi" i harduerit dhe softuerit</p>	<p>Humbja e informatave rreth aseteve të trashëgimisë kulturore</p>	<p>Përditësimi i rregullt i inventarit</p> <p>Kopje rezervë</p> <p>Përmirësimi i strukturës së brendshme menaxheriale (sikurse komunikimi dhe bashkëpunimi më i mirë ndërmjet stafit) në mënyrë që të sigurohet se puna është kryer, si dhe të shmangë humbjen e informatave p.sh. në rast të pensionimit të stafit</p>
<p>4.3 Praktikave të gabuara të ruajtjes- konservimit</p> <p>Ndërrhyrja (nxitja për të vepruar pa bazë të njohurive)</p> <p>Mungesa e të kuptuarit të kontekstit</p>	<p>Përkeqësimi i ndërtesës dhe i komponentëve të tij</p> <p>Humbja e vlerave të trashëgimisë kulturore</p>	<p>Ndarja e praktikave të mira</p>

Cilat janë rreziqet ndaj trashëgimisë kulturore në Kosovë?

Kjo pjesë e Raportit përpiket të paraqesë rreziqet dhe dobësitë kryesore të identifikuar ndaj trashëgimisë kulturore në Kosovë. Disa prej këtyre rreziqeve në Kosovë janë identifikuar nga autoritetet dhe agjencitë përmes vlerësimit të rrezikut ose studimeve të tjera. Sidoqoftë, ekzistojnë disa të dhëna statistikore të cilat paraqesin informacione të mbledhura rreth ngjarjeve paraprake të rreziqeve natyrore ose rreziqeve të tjera. Për shkak të mungesës së informatave për zonat me rrezikshmëri të lartë të fatkeqësive dhe vështirësive në qasjen e të dhënave rreth rreziqeve, në Kosovë është e vështirë të kemi një pasqyrë të qartë të rreziqeve më të përhapura. Për të forcuar, pasuruar të dhënat e këtij raporti, intervistimi i përgjegjësve të emergjencave, autoriteteve lokale, si dhe të publikut të gjerë, mund të ishte i dobishëm, mirëpo në mungesë të kohës kjo pjesë nuk përfshihet në këtë raport.

Rreziqet

Rreziqet natyrore

Në Kosovë ekziston rreziku i përmbytjeve në disa zona të ulëta, veçanërisht në pellgun e Drinit. Ferizaj në vitin 1973 ishte ndër qytetet e ndikuara nga përmbytjet. Në mes të nëntorit të vitit 2007 deri në qershor të vitit 2008, vendi përjetoi përmbytje të mëdha, ku rreth 3500 njerëz u zhvendosën, ndërsa pati dëme të mëdha edhe në infrastrukturë e në toka pjellore. Në vitin 2010 dhe në 2014, dy përmbytje të mëdha sërish goditën vendin. Krahas rrezikut të përmbytjeve në zona të ulëta, në disa burime flitet edhe për rrezikun e përmbytjeve për shkak të digave të dobëta. Kjo ndodhi veçanërisht në Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë e Gjakovë. Në disa qytete u raportua se përmbytjet ndodhin për shkak të problemeve me sistemet e drenazhimit dhe kanalizimit. Në Prishtinë së fundmi janë marrë disa masa për të përmirësuar sistemin e kanalizimit, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i përmbytjeve. Përmbytjet ndodhin edhe në zonat malore si pasojë e reshjeve të mëdha dhe ndonjëherë rezultojnë edhe me rrëshqitje të dheut.

Edhe rrëshqitjet e dheut janë njëra ndër rreziqet me të cilat mund të përballet Kosova. Sidoqoftë, ato janë të rralla (probabiliteti i shkallës së rasteve është 1% në vit) ndërsa zonat të cilat preken nga ky rrezik janë kryesisht Mitrovica, Prishtina, Peja dhe Shtërpca.

Duke qenë se 43% e territorit të Kosovës është e mbuluar me pyje, një prej rreziqeve të rëndësishme është edhe zjarri në pyje. Kështu, çdo vit në Kosovë janë rreth 2000 deri në 3000 intervenime kundër zjarrit. Që nga viti 2000 është vërejtur rritja e numrit të zjarreve në pyje, që shkon me një rritje të numrit të valëve të nxehtësisë dhe thatësisë. Për shembull, thatësira ka ndodhur në vitet 1993, 2000, 2007, 2008 dhe 2013. Gjatë verës së vitit 2007, në disa pjesë të Kosovës



Në mes të viteve 1456 dhe 2014, Kosova ka qenë e goditur nga gjithsej 152 tërmete me madhësi prej 3.5 deri në 6.3 shkallë të Rihterit.

temperaturat kanë arritur deri në 43°C, duke shkaktuar vdekjen e mbi 1000 personave në nivel vendi, krahasuar me mesataren e viteve 1994–2008. Për më tepër, për shkak të rritjes së numrit të thatësisë, 80% e komunave shumë shpesh patën mungesë të ujit. Në anën tjetër, periudhat e të ftohtit mund të godasin Kosovën gjatë dimrit dhe mund të ketë reshje të mëdha, të cilat kontribuojnë në rreziqet nga përmytjet në disa pjesë të vendit.

Një tjetër rrezik natyror në Kosovë janë edhe tërmetet. Në fakt, Kosova është e vendosur në një zonë sizmike. Në mes të viteve 1456 dhe 2014, Kosova ka qenë e goditur nga gjithsej 152 tërmete me madhësi prej 3.5 deri në 6.3 shkallë të Rihterit. Çdo vit në Kosovë ekziston probabiliteti prej 27.8% që të ndodhë një tërmet i shkallës deri në 5.0. Ndërsa gjasat për të goditur një tërmet i shkallës 6.0 çdo 50 vjet janë 51.2%. Edhe pse gjasat mbesin të ulëta, rreziku nuk duhet të neglizhohet, për shkak të pasojave të rëndësishme që mund të shkaktojë. Për shembull, në vitin 2002 në Gjilan si pasojë e një tërmeti pati dëmtime dhe shkatërrime të mëdha, pas të cilit u evakuuan shumë njerëz. Një tjetër shembull është edhe tërmeti i cili goditi Shkupin në vitin 1963. Shkupi është vetëm disa kilometra larg Kosovës, ndërsa tërmeti shkaktoi shkatërrimin e rreth 40% të qytetit dhe vdekjen e 1300 personave.

Tërmetet më të rëndësishme që kanë ndodhur në Kosovë që nga viti 2000:



Vendi	Data	Magnituda epiqendrës
Gjilan	24/4/2002	5.7
Istog	10/3/2010	4.6
Vushtrri	18/11/2013	4.1
Dubovë	21/1/2015	4.4

Sipas parashikimeve të ndryshme klimatike, thatësitrat, valët e nxehtësisë, periudhat e të ftohtit, ngjarjet ekstreme klimatike, si dhe zjarret mund të rriten në të ardhmen.

Rreziqet teknologjike të shkaktuara nga njeriu

Kosova nuk goditet vetëm nga rreziqet natyrore. Për shembull, një nga problemet më të mëdha në qytete, veçanërisht në Prishtinë, është ndotja e ajrit, ku burimet kryesore të ndotjes janë dyoksidi i sulfurit (SO₂), oksidet e azotit NO dhe NO_x, ozoni (O₃), CO, monoksidi i karbonit (CO) dhe dyoksidi i karbonit (CO₂), VOCs dyoksina, plumbi dhe grimcat. Ndotja e ajrit në Prishtinë është si pasojë e djegies së qymyrit dhe drurit me qëllim të prodhimit të energjisë dhe ngrohjes. Në fakt, kompanitë e ngrohjes "Kosova A" dhe "Kosova B" janë të vendosura në Obiliq, në afërsi të Prishtinës. Duke marrë parasysh këtë problem, ndotja e ajrit është problem kryesisht në sezonin e dimrit.

Ekziston edhe një rrezik i lartë i zjarrit në vendbanimet urbane. Për më tepër, në Kosovë ka vende të rrezikshme industriale, posaçërisht në afërsi të Prishtinës. Ato mund të jenë të dëmshme në rast të ndonjë incidenti (si shpërthim, rrjedhje etj.) të cilat mund të kontribuojnë në ndotjen e ajrit.

Rreziqet sociale

Kosova ka shpallur Pavarësinë e saj në vitin 2008, por raportet e saj me Serbinë, e cila ende nuk e ka njohur realitetin e ri në Kosovë, janë të tensionuara dhe shpesh edhe të provokuara. Në vitin 2017, autoritetet serbe provuan ta nisin një tren për në Kosovë me mbishkrime provokuese për Kosovën, rast që rriti tensionet politike në shkallën më të lartë. Në anën tjetër, komuniteti serb në Kosovë, në masë të madhe i ndikuar nga autoritetet serbe, edhe më tej nuk është integruar plotësisht në sistemin shtetëror të Kosovës. Nëse tensionet në mes të dy shteteve nuk tentojnë të zvogëlohen, ekziston shkalla e lartë e rreziqeve për trazira etnike. Trazirat e vitit 2004 treguan se ekzistojnë ende tensione në mes të grupeve etnike, të cilat mund të çojnë në trazira sociale me viktima, të plagosur dhe shkatërrim të ndërtesave dhe të infrastrukturës. Gjatë trazirave të vitit 2004 dhe të luftës së vitit 1999, shënjestër kryesore e shkatërrimit ishin kryesisht ndërtesat e rëndësishme religjioze.

Vlerësimi i cenueshmërisë (ndjeshmërisë)

Vlerësimi i cenueshmërisë është bërë me fokus të veçantë në zonat urbane. Në fakt, një pjesë e madhe e ndërtesave të trashëgimisë kulturore, si dhe muzetë në Kosovë, janë të ndërtuara në kontekstin urban.

Cenueshmëria (ndjeshmëria) socio-ekonomike

Kosova është një ndër vendet më pak të zhvilluara të Ballkanit e të Evropës. Niveli i varfërisë është i lartë, gjë që bën që popullata të jetë më e ndjeshme ndaj kërcënimeve shëndetësore e fatkeqësive natyrore. Në vitin 2012, GDP-ja për kokë banori ishte 2.721 €, ndërsa shkalla e inflamacionit ishte 2.1%. Papunësia është e lartë veçanërisht në mesin e të rinjve. Në vitin 2012, shkalla e punësisë



Gjatë trazirave të vitit 2004 dhe të luftës së vitit 1999, shënjestër kryesore e shkatërrimit ishin kryesisht ndërtesat e rëndësishme religjioze.

ishte vlerësuar të jetë 35.1%. Sa i përket demografisë, Kosova karakterizohet me një popullatë shumë të re, me gjysmën e popullsisë nën moshën 25- vjeçare. Fatkeqësisht të rinjtë janë më të varfër, me rreth 40% njerëz të varfër që janë nën moshën 20-vjeçare dhe rreth 60% të njerëzve të varfër nën moshën 30-vjeçare.

Ndërgjegjësimi i popullatës ndaj rrezikut është i ulët, gjë që e rrit ndjeshmërinë dhe çon në sjellje me rrezikshmëri të lartë, sikurse ato që lidhen me ndërtimin e shtëpive në zona me rrezikshmëri të lartë, që do të përshkruhet më poshtë.

Cenueshmëria fizike dhe mjedisore në zonat urbane të Kosovës

Shumica e qyteteve të Kosovës kanë pësuar ndryshime dramatike pas luftës së vitit 1999. Kjo ka çuar në një urbanizim i cili nuk ishte i kontrolluar në mënyrë adekuate nga Qeveria e vendit. Si pasojë u ndërtuan shumë objekte ilegale (sipas Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në Prishtinë janë ndërtuar rreth 2500 ndërtesa ilegale në toka të ndërmarrjeve publike) dhe disa prej tyre janë të vendosura në zona potencialisht të rrezikshme. Urbanizimi i paplanifikuar dhe i pakontrolluar rezultoi në një numër të madh ndërtesash, të cilat nuk i respektojnë kodet dhe standardet e ndërtimit. Kjo bën që ato të jenë veçanërisht të rrezikuara ndaj tërmeteve. Për këtë arsye thuhet se ndërtesat që datojnë nga paralufta kanë shanse më të mëdha t'u bëjnë ballë tërmeteve, pasi ato me shumë gjasë kanë respektuar kodet e ndërtimit dhe llogaritjet sizmike gjatë ndërtimit. Në tërësi, disa burime vlerësojnë se në Prishtinë 89-90% e numrit të përgjithshëm të ndërtesave të reja nuk i respektojnë kodet sizmike.

Përveç kësaj, afërsia e ndërtesave me njëra-tjetrën në qytete është po ashtu shqetësuese, meqë ato mund të shkaktojnë dëme shtesë në rast të tërmetit. Për më tepër, kjo mund të rritë, po ashtu, edhe pasojat e ndonjë zjarri për të njëjtat arsye (dëme kolaterale), e gjithashtu edhe vështirëson qasjen e zjarrfikësve për shkak të afërsisë së ndërtesave mes vete. Rreziku ndaj zjarrit rritet gjithashtu, sepse jo secila ndërtesë ka hidrant të ujit, furnizim funksional me ujë, aparate për fikjen e zjarrit, apo plane ose rrugë të evakuimit. Krahas tyre, shumë ndërtesa nuk kanë hapësira të mjaftueshme dhe nuk i plotësojnë standardet për të siguruar që ato në raste emergjente të mund të përdoren si shkallë kundër zjarrit. E në fund, një burim tjetër i ndjeshmërisë ndaj zjarrit është mungesa e resurseve dhe e pajisjeve të zjarrfikësve, sikurse edhe personeli i pamjaftueshëm (sipas standardeve të EU-së, për çdo 1000 banorë duhet të jetë një zjarrfikës).

Ndryshimet e pasluftës të vitit 1999 kanë rezultuar gjithashtu edhe me migrimin e popullsisë nga zonat rurale në ato urbane. Për shkak të rritjes së vazhdueshme të popullsisë, ka pasur probleme edhe me furnizimin me ujë, e mungesa e ujit u bë problem edhe më i madh në periudhat e thatësisë. Sa i përket mjedisit, kjo rritje e vazhdueshme e popullsisë ka ndikuar në rritjen e bllokimit të trafikut dhe në ndotjen e ajrit, veçanërisht, pasi që, për shkak të sistemit të dobët të transportit publik, veturat

private janë mjete kryesor i transportit.

Një tjetër ndjeshmëri e identifikuar në zonat urbane është edhe mungesa e buxhetit të alokuar në nivel komunal për uljen e rrezikut nga fatkeqësitë ose menaxhimin e rrezikut ndaj fatkeqësive. Zakonisht komuna rimbursen dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë, ndërkohë që alokimi i mjeteve për masat për zbutjen dhe parandalimin e fatkeqësive mund të ishte më përfituese në një periudhë afatgjatë, si dhe më e qëndrueshme. Krahas saj, rreziqet natyrore nuk janë paraqitur si duhet në planet zhvillimore urbane. Një tjetër efekt që menaxhimi i rrezikut ndaj fatkeqësive është i kufizuar është edhe mungesa e vetëdijes së popullatës ndaj rreziqeve.

1. Vërejtje përmbyllëse

Ky kapitull paraqet disa njohuri të përgjithshme rreth rreziqeve të ndryshme të cilat mund të prekin asetet e trashëgimisë kulturore. Po ashtu prezantohen edhe informatat rreth faktorëve të përkeqësimit, pasojat/ humbjet potenciale dhe disa masave për të zvogluar rreziqet apo pasojat e rreziqeve. Bashkë me një pasqyrë të shpejtë të situatës në Kosovë lidhur me ekspozimin e saj ndaj rreziqeve dhe dobësitë kryesore të vendit, mund të nxirren edhe disa përfundime se cilat janë rreziqet të cilat duhet të prioritetizohen.

Në nivelin nacional, nga perspektiva e trashëgimisë kulturore tërmetet dhe zjarri duket të jenë rreziqet më urgjente, pasi që pasojat mund të jenë jashtëzakonisht të mëdha. Më tepër ka gjasa të ketë një zjarr sesa një tërmet, e në anën tjetër masat për zbutjen/ mënjanimin e rrezikut ndaj zjarrit janë më të lehta për tu zbatuar. Andaj, në këtë raport fokusohet në rreziqet ndaj zjarrit, edhe pse nuk kjo nuk do të thotë që duhet menjanuar rreziqet tjera.

2


Kërcënimi i muzeve nga zjarri

Qëllimi i këtij kapitulli është të ofrojë informata më të hollësishme mbi rrezikun nga zjarri, për të kuptuar më mirë se në çfarë mënyrash mund të rrezikohen asetet e trashëgimisë kulturore nga zjarri. Gjithashtu ofron disa shembuj për masat që duhen ndërmarrë për të zvogëluar gjasat, si dhe pasojat në raste të zjarrit.

Specifikat në kontekstin e ndërtesave historike dhe muzeve

Në përgjithësi, pasuritë më të vlefshme që duhet mbrojtur në muze janë koleksionet. Megjithatë, disa muze janë të vendosura në ndërtesa të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, dhe si të tilla, krahas përmbajtjes së ndërtesës, edhe vetë ndërtesa është shumë e vlefshme. Në Kosovë hasim që kryesisht muzetë etnologjikë të jenë të vendosur në shtëpi tradicionale.

Ndonëse themelimi i një muzeu në një ndërtesë historike është e përshtatshme, si dhe mund të jetë edhe estetike (sidomos në rastet e muzeve etnografike), ajo po ashtu ka edhe sfida të ndryshme. Në të vërtetë, koleksionet e muzeve zakonisht janë të veçanta dhe shumë të çmuara, ato jo vetëm që kanë vlerë të madhe monetare, por përmbajnë edhe vlerë të fuqishme simbolike. Koleksionet nuk mund të zëvendësohen, prandaj themelimi i tyre në ndërtesa moderne dhe të destinuara kryesisht për këtë qëllim shpeshherë është më mirë, në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje më e mirë e tyre. Në fakt, ndërtesat historike shpesh janë të ndërtuara nga materiali i drurit ose kanë sistem të vjetër elektrik, kështu që është më vështirë të mbrohen nga zjarri. Për këto arsye mbrojtja nga zjarri duhet të jetë më e madhe në që janë të vendosura në ndërtesat e trashëgimisë kulturore.



Burimet e zjarreve

Një zjarr mund të shkaktohet për arsye të ndryshme. Identifikimi i burimeve të mundshme të zjarrit është hapi fillestar, në mënyrë që të mundë të merren masat adekuate për t'iu kundërvënë.

Para së gjithash, duhet bërë dallimin në mes të zjarrvënies aksidentale dhe asaj të qëllimshme. Zjarrvëniet e qëllimshme janë akte të dëmshme, të cilat mund të kenë motive të ndryshme. Në anën tjetër, zjarrvëniet aksidentale mund të jenë për shkak të defekteve elektrike, punëve rinovuese (për shkak të punëve të nxehta sikurse është saldimi), përdorimi i qirinjeve, ose për shkak të pajisjeve të ngrohjes.

Burimi i një zjarri mund të jetë si brenda ndërtesës, ashtu edhe në rrethinën e tij. Për shembull, një zjarr mund të fillojë për shkak të mbeturinave në tokë, apo mund të fillojë në ndërtesat fqinje e potencialisht mund të përhapet në një ndërtesë tjetër. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme të kontrollohet infrastruktura përreth muzeve, në mënyrë që të identifikohen të gjitha burimet potenciale të zjarrit.

Pasojat e zjarreve

Një zjarr mund të shkaktojë humbje të pakthyeshme dhe kështu mund të ketë pasoja të jashtëzakonshme. Në të vërtetë, një zjarr mund të djegë plotësisht apo pjesërisht duke shkatërruar kështu artefakte, objekte apo edhe ndërtesa. Tymi, sikurse edhe depozitimi i blozës, mund të shkaktojë dëme të drejtpërdrejta në një ndërtesë ose në komponentët e saj. Për më tepër, temperaturat e larta gjatë zjarrit mund të

Zjarret mund të kenë edhe pasoja indirekte. Për shembull, përdorimi i ujit për fikjen e zjarrit nga zjarrfikësit apo përdorimi i impianteve, spërkatësve të ujit, (sprinkler) mund të shkaktojnë dëmtime të mëdha brenda ndërtesës.

shkaktojnë shkrirjen, deformimin apo humbjen e ngjyrës të disa ndërtesave. Forcat fizike të shkaktuara nga zjarri mund të shkaktojnë edhe rënien e objekteve ose dëme strukturale të cilat mund të çojnë deri në rrënimin e disa pjesëve të ndërtesës.

Zjarret mund të kenë edhe pasoja indirekte. Për shembull, përdorimi i ujit për fikjen e zjarrit nga zjarrfikësit apo përdorimi i impianteve, spërkatësve të ujit, (sprinkler) mund të shkaktojnë dëmtime të mëdha brenda ndërtesës. Dëmet e ujit mund të shkaktojnë lagështi të madhe, myk e korrozion. Gjithashtu, rezultat i zjarrvënies mund të jetë edhe humbja e informatave rreth objekteve, si pasojë e djegies së dokumentacionit dhe e emërtimit të tyre.

Çfarë mund të bëjmë për të zvogëluar rrezikun nga zjarri?

Masa të ndryshme mund të zbatohen, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga zjarri. Kështu, mund t'i ndajmë masat që parandalojnë një zjarr, ato të cilat zvogëlojnë pasojat e një zjarri, si dhe masat përgatitore që lehtësojnë reagimin në raste të zjarreve.

Parandalimi i një zjarri

Zbatimi i masave të cilat ndihmojnë në parandalimin e një zjarri është i mundshëm. Për shembull, zjarrvëniet e qëllimshme mund të parandalohen përmes hyrjes së kontrolluar në një ndërtesë, si dhe përmes një sistemi të mbikëqyrjes (rojave, kamerave e alarmeve të sigurisë).

Lidhur me llojet e tjera të zjarrvënies duhet të identifikohen burimet e ndezjes, me qëllim të mënjanimin të rreziqeve, apo nëse mund të mënjanohen, të paktën duhet të jemi të vetëdijshëm për këto rreziqe. Për më tepër, duhet të zbatohen disa masa të thjeshta sikurse janë: ndalimi i pirjes së duhanit, shmangia e përdorimit të pajisjeve mobile të ngrohjes, shkyçjet e pajisjeve elektrike në rastet kur ato nuk përdoren, si dhe vendosja e materialeve nga pëlhura në distancë të caktuar nga llambat apo qirinjtë.

Mirëmbajtja e duhur e ndërtesave është po ashtu një prej masave të rëndësishme të parandalimit ndaj zjarrit. Përveç pastrimit dhe largimit të mbeturinave që mund të jenë burim i mundshëm i ndezjes, mirëmbajtja është e rëndësishme, pasi që përmes saj mund të vërehet ndonjë prishje elektrike. Prandaj, me qëllim të parandalimit të zjarreve është shumë e rëndësishme të kryhen inspektimet e rregullta të ndërtesës, për t'u siguruar që të gjitha pajisjet elektrike të jenë të fikura apo të shkyçura. Inspektimet janë të rëndësishme veçanërisht në rastet kur brenda ndërtesës ka ndonjë punë rinovuese.

Zbutja: Zvogëlimi i pasojave të mundshme nga zjarri

Zjarri jo gjithmonë mund të shmanget, dhe për këtë arsye është e rëndësishme të

merren disa masa të cilat i reduktojnë pasojat e mundshme nga ai. Masa e parë që duhet të merret është instalimi i një sistemi të mirë detektues, sikurse sensorë të tymit apo nxehtësisë. Në të vërtetë, sa më herët që zbulohet një zjarr është më mirë, në mënyrë që të shmangen dëmtime të rëndësishme.

Po ashtu, janë disa masa të cilat mund të ndihmojnë në kufizimin e përhapjes së zjarrit. Për shembull, aktivizimi i sistemit për shuarjen e zjarrit. Aparatet për fikjen e zjarrit janë pajisjet më të përhapura (zakonshme) dhe ato duhet të jenë të vendosura në vende të dukshme e strategjike. Ekzistojnë edhe sisteme të tjera të shuarjes së zjarrit, siç janë sprinklerët, të cilët aktivizohen në mënyrë automatike nga nxehtësia që shkaktohet nga zjarri. Mbrojtësit strukturalë ndaj zjarrit po ashtu zvogëlojnë përhapjen e zjarrit nga dhoma ku ai ka filluar në pjesë të tjera të ndërtesës. Këtu përfshihet: ndarjen e ndërtesës, përdorimin e materialeve të cilat parandalojnë rrënimin e ndërtesës, ose shkallë rezistuese ndaj zjarrit. Fatkeqësisht, këto masa janë vështirë të zbatueshme në ndërtesat historike, meqë kjo do të nënkuptonte ndryshime të shumta strukturale. Megjithatë, këto masa janë dëshmuar të jenë shumë efektive: p.sh. shkallët e mbyllura do të funksionojnë si barrierë, pengesë, për tym dhe zjarr, përderisa shkallët e hapura shpeshherë funksionojnë si oxhak dhe kontribuojnë në përhapjen e zjarrit nga një kat në tjetrin. Kufizimi i përhapjes së zjarrit po ashtu përfshin parandalimin e zjarrit për të arritur deri tek artefaktet. Për shembull, disa muze janë të furnizuara me pajisje të cilat janë të dizajnuara në atë mënyrë që të mbajnë një temperaturë të ulët në enterier.

Në mënyrë që të kufizohen pasojat, gjithashtu është shumë e rëndësishme qasja e mirë në ndërtesë për zjarrfikësit. Për më tepër, qasja e mirë në ujë do të ndihmonte mjaftueshëm në reagim të shpejtë në rast të zjarreve.

Përfundimisht, reduktimi i pasojave ndaj zjarrit nënkupton edhe ruajtjen e jetës së njerëzve. Prandaj evakuimi dhe alarmet paralajmëruese janë ndër masat e rëndësishme që ndihmojnë në evakuimin e shpejtë të njerëzve brenda ndërtesës. Krahas alarmeve të evakuimit, shenjat e daljes dhe planet e evakuimit të vendosura në mure do të lehtësojnë shumë procesin e evakuimit. Planet e evakuimit duhet të jenë të vendosura në pozita strategjike dhe ato duhet të tregojnë rrugët e daljes, si dhe kontaktet e sigurt të shërbimeve të shpëtimit.

Përgatitja për reagim

Të qenët i përgatitur është shumë e rëndësishme për të siguruar reagimin e duhur në raste të zjarreve. Një nga aspektet thelbësore të përgatitjes është trajnimi i rregullt i stafit. Kjo përfshin njohurinë se si duhet reaguuar në raste të zjarrit, duke organizuar ose ndihmuar evakuimin e njerëzve ose të artefakteve, si dhe njohurinë se si të përdoren pajisjet për shuarjen e zjarrit. Në rastin e muzeve, ato gjithashtu përfshijnë procedurë emergjente lidhur me bartjen apo shuarjen e zjarrit të artefakteve.

Trajnimet mund të zhvillohen përmes stërvitjeve dhe ushtrimeve stimuluese, të cilat janë veçanërisht të dobishme për të identifikuar përparësitë dhe mangësitë e reagimit në vend dhe përmirësimin e tij nëse është e nevojshme. Gjithashtu është mënyrë e mirë të testohet nëse sistemet për shuarjen e zjarrit punojnë, nëse shenjat ku tregojnë daljen janë të vendosura në vendin e duhur, nëse rrugët e evakuimit janë të hapura, të pastruara nga objektet, si dhe nëse daljet mund të hapen lehtësisht. Këto aspekte duhet të kontrollohen në baza të rregullta.

Aspekt tjetër i rëndësishëm për përgatitje është edhe krijimi i bashkëpunimit me brigadën e zjarrfikësve. Në fakt, njohja e ndërtesës dhe e komponentëve të saj do të ndihmonte zjarrfikësit të jenë më efektivë dhe do të sigurohej që kanë materialet dhe njohuritë adekuate. Prandaj rekomandohet përfshirja e zjarrfikësve në stërvitje.

Në fund, është i domosdoshëm krijimi i një udhëzuesi të procedurave emergjente, për të qenë më të përgatitur në raste të zjarrvënies. Ky udhëzues duhet të hartohet me përfshirjen e të gjitha palëve relevante. Përmban përmbledhjen e të gjitha masave në një vend për të zvogëluar rrezikun ndaj zjarrit, sikurse edhe rolin e aktorëve në raste emergjente, në mënyrë që të sigurohet një reagim i koordinuar. Ky dokument duhet të rishikohet dhe të përditësohet shpesh, me qëllim që të jetë gjithmonë në përputhje me kontekstin.


3

Vlerësimi i rrezikut nga *zjarri* në Muzetë e Kosovës

Kjo pjesë e studimit ka në fokus vlerësimin e rrezikut ndaj zjarrit në disa muze të Kosovës. Ky vlerësim ndihmon në identifikimin dhe prioritetin e disa masave që duhet të ndërmerren në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje më e mirë e muzeve dhe e koleksioneve të tyre në Kosovë.

13

MUZE TË VLERËSUARA



Prishtinë	Muzeu Kombëtar i Kosovës
Prishtinë	Galeria Kombëtare e Kosovës
Gjakovë	Muzeu Etnografik i Gjakovës
Gjakovë	Muzeu i Familjes Qerkezi
Gjakovë	Muzeu Historik
Pejë	Muzeu Etnografik i Pejës
Prizren	Muzeu Arkeologjik
Prizren	Muzeu Etnologjik i Prizrenit
Prizren	Lidhja Shqiptare “Lidhja e Prizrenit”
Ferizaj	Muzeu i Ferizajt
Gjilan	Muzeu i Gjilanit
Mitrovicë	Muzeu i Mitrovicës
Mitrovicë	Muzeu i Kristaleve në Stantërg

Muzeu Kombëtar i Kosovës

Emri: **MUZEU I KOSOVËS**

Adresa: **Rr. "Ibrahim Lutfiu", Prishtinë**

Data e ndërtimit: **1885/6**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Muze**

Pronari: **Ministria e Kulturës**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore, nuk
ekziston asnjë rregullore e brendshme.**

Lloji i arkitekturës: **Arkitekturë Austro-Hungareze**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje Qendrore**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu financohet nga Ministria e Kulturës dhe ka të punësuar 33 anëtarë të përhershëm dhe 9 anëtarë të përkohshëm të stafit. Sipas të intervistuarit, nuk ekzistojnë burime të mjaftueshme financiare dhe Muzeu ka nevojë për më shumë staf profesional (si biologë etj.) për të siguruar një funksionim më të mirë të tij.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu i Kosovës ndodhet në qendër të Prishtinës. Edhe pse nuk ekziston një tampon zonë rreth pronës së Muzeut, nuk ekziston ndonjë ndërtesë dhe infrastrukturë ndërhyrëse, sikurse janë linjat elektrike etj., si dhe rrugët nuk gjenden shumë afër ndërtesës së Muzeut. Prandaj burimet e jashtme të zjarrit që mund të përhapen dhe të kenë ndikim në Muze janë të kufizuara.

Vlerësimi i cenueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Ndërtesa është e ndërtuar nga guri ranor dhe nuk paraqet ndonjë material të ndezshëm të veçantë sikurse druri. Për më tepër, në ndërtesë nuk janë vërejtur burime të ndezjes. Gjithashtu nuk ka punë ndërtimore brenda pronës së Muzeut. Prandaj aspektet fizike të ndërtesës nuk duket se tregojnë që rreziku nga zjarri për Muzeun e Kosovës është i lartë.

Muzeu duket të jetë i mirëmbajtur mirë, duke e mirëmbajtur, pastruar shpesh. Megjithatë, instalimet elektrike dhe pajisjet kontrollohen vetëm me kërkesë të stafit, dhe ndonjë defekt apo prishje mund që të mos vërehet për shkak të kësaj. Një defekt apo prishje në instalimet elektrike mund të jetë një burim i mundshëm i zjarrit, dhe për këtë arsye rekomandohet që të bëhen inspektime të rregullta

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Zjarrfikësit e kanë të lehtë për t’iu qasur ndërtesës së Muzeut, pasi që ekziston një rrugë afër tij dhe për shkak të oborrit të madh para ndërtesës së Muzeut. Ndoshta komunikacioni rrugor mund të ndikojë në qasjen e mirë në ndërtesë, pasi qendra e qytetit të Prishtinës shpesh mund të jetë e mbingarkuar me komunikacion rrugor.

Ndërtesa është e pajisur me sensorë të tymit dhe aparate për fikjen e zjarrit. Sipas stafit, nuk ka spërkatës, për shkak të pranisë së koleksioneve që mund të prishen nga uji. Ka një qasje të lehtë në ujë, sidomos për shkak të pranisë së hidrantëve në ndërtesë, që do të lehtësonin punën e zjarrfikësve në rast zjarri. Për më tepër, pirja e duhanit është e ndaluar. Nuk ka shenja të mjaftueshme daljeje.

Problemi me pajisjet e sigurisë kundër zjarrit, dhe veçanërisht me aparatet për fikjen e zjarrit, është se ato nuk janë testuar dhe gjithashtu nuk janë shfaqur në një vend të dukshëm në Muze, gjë që zvogëlon shumë efikasitetin e tyre si pajisje për mbrojtje nga zjarri.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi

Mosekzistimi i një plani të evakuimit në rast të zjarrit do të thotë se nuk ka zona të caktuara për evakuim emergjent dhe se dalja më e afërt, si dhe vendndodhja e saktë e pajisjeve kundër zjarrit, siç janë aparatet për fikjen e zjarrit, nuk janë të specifikuar.

Nuk ekziston ndonjë procedurë udhëzuese emergjente për Muzeun e Kosovës. Ky dokument do të ishte i rëndësishëm për t'u zbatuar, pasi që ndihmon në caktimin e personit përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e veprimeve që duhen ndërmarrë në rast zjarri dhe gjithashtu ndihmon në përcaktimin paraprakisht se cilat do të jenë kanalet e komunikimit që do të përdoren në rast të një zjarri. Në thelb, ky dokument do të ndihmonte që të ketë një ide se cila do të jetë procedura që duhet ndjekur (duke qenë fleksibël) në rast zjarri, në mënyrë që të zvogëlohen pasojat e zjarrit sa më shumë që të jetë e mundur dhe për të siguruar një reagim të mirë. Megjithatë, sipas të intervistuarit, është një pikë e mirë, pasi që ekziston një komunikim i mirë midis anëtarëve të stafit. Është një shenjë e mirë për zbatimin e një plani të tillë që mund të testohet gjatë trajnimeve nga anëtarët e stafit.

Trajnimet

Sa u përket trajnimeve, vetëm dy anëtarë të stafit janë trajnuar lidhur me rrezikun nga zjarri. Ata, megjithatë, nuk ishin të trajnuar për evakuimin e artefakteve. Trajnimet dhe stërvitjet simuluese brenda ndërtesës dhe me përfshirjen e të gjithë anëtarëve të stafit nuk janë organizuar asnjëherë, dhe për këtë arsye nuk ekziston ndonjë rol i përcaktuar ndërmjet stafit në rast emergjence. Për më tepër, nuk ka bashkëpunim me zjarfikësit, të cilët për këtë arsye nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në ndonjë stërvitje të simuluar në Muze dhe as nuk kanë njohuri specifike ose pajisje specifike për t'u ballafaquar me zjarret në Muze (që mund të zvogëlojë dëmin e panevojshëm nga uji në ndërtesat dhe gjësendet që gjenden në të gjatë ndërhyrjeve).

Siguria

Qasja në Muze të Kosovës kontrollohet nga rojat e sigurisë që gjenden në ndërtesë çdo ditë dhe natë. Për më tepër, ndërtesa është e pajisur me kamera, por nuk ka ndonjë sistem alarmi. Në përgjithësi, siguria është e mirë për të parandaluar zjarrvëniet.

Koleksionet

Muzeu ka një inventar të koleksioneve dhe i ka të etiketuara artefaktet e ndryshme të Muzeut. Të gjitha artefaktet kanë numrat e tyre rendorë. Për më tepër, koleksionet janë të dokumentuara dhe disa prej tyre janë të digjitalizuara në një bazë të dhënash.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu i Rrethikshmëria nga Kosovës zjarri për shkak	
Ulët Mjedisit	
Ulët Aspektit fizik të ndërtësës	
Ulët Mungesës së mirëmbajtjes	
Ulët Mungesës së qasjes	
Mesatare Mungesës së pajisjeve	
Lartë Mungesës së trajnimeve	
Lartë Mungesës së plan. emergjent	
Ulët Mungesës së sigurisë	

Galeria Kombëtare e Kosovës

Emri: **Galeria Kombëtare e Kosovës**

Adresa: **Rr. "Agim Ramadani", Prishtinë**

Data e ndërtimit: **1935**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Galeri e Arteve**

Pronari: **Ministria e Kulturës**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Rregullorja e Brendshme.**

Ventilimi: **Natyror dhe klimatizim**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje elektrike (ngrohja qendrore nuk punon)**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**

Menaxhimi i ndërtesës

Galeria Kombëtare financohet nga Ministria e Kulturës dhe ka të punësuar një ekip prej 12 anëtarësh të stafit. Sipas të intervistuarit, nuk ekzistojnë burime të mjaftueshme financiare, si dhe nuk ka burime të mjaftueshme njerëzore për të siguruar një funksionim më të mirë të Galerisë.

Informata në lidhje me zonën përreth

Galeria Kombëtare e Kosovës ndodhet në qendër të Prishtinës, afër Bibliotekës Kombëtare. Edhe pse nuk ekziston një tampon zonë rreth pronës së Galerisë, nuk ekziston ndonjë ndërtesë dhe infrastrukturë ndërhyrëse, sikurse janë linjat elektrike etj., si dhe rrugët nuk gjenden shumë afër ndërtesës së Galerisë. Prandaj burimet e jashtme të zjarrit që mund të përhapen dhe të kenë ndikim në Galeri janë të kufizuara.

Vlerësimi i cënueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Galeria duket të jetë e mirëmbajtur mirë, duke e mirëmbajtur, pastruar shpesh. Ndërtesa nuk paraqet ndonjë material të ndezshëm të veçantë sikurse druri, si dhe për momentin nuk është duke u kryer ndonjë punë ndërtimore brenda pronës së Muzeut. Për më tepër, në ndërtesë nuk janë vërejtur burime të ndezjes, dhe pirja e duhanit është e ndaluar. Megjithatë, ndërtesa është e pajisur me ngrohje qendrore, por nuk ka gjenerator. Por një çështje e rëndësishme për t’u përmendur është se ngrohja qendrore nuk po funksionon dhe për këtë arsye përdoret ngrohje shtesë elektrike, që paraqet një rrezik më të madh duke qenë burim i zjarrit.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Zjarrfikësit e kanë të lehtë për t’iu qasur ndërtesës së Galerisë pasi që ekziston një rrugë kryesore aty pranë. Ndoshta komunikacioni rrugor mund të ndikojë në qasjen e mirë në ndërtesë, pasi qendra e qytetit të Prishtinës shpesh mund të jetë e mbingarkuar me komunikacion rrugor. Për më tepër, aty ka shumë vetura të parkuara në ambientin përreth ndërtesës, që potencialisht mund të pengojnë qasjen në ndërtesë.

Ndërtesa është e pajisur me aparate për fikjen e zjarrit, por sensorët e tymit janë të vendosur vetëm në zonën kryesore të ekspozitave. Nuk ka spërkatës, por ndërtesa është e pajisur me hidrantë dhe ka qasje të lehtë në ujë. Pajisjet kundër zjarrit testohen çdo 6 muaj dhe kështu ndjekin rekomandimet në lidhje me shpeshhtësinë e testimit të pajisjeve kundër zjarrit.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi

Mosekzistimi i një plani të evakuimit në rast të zjarrit do të thotë se nuk ka zona të caktuara për evakuim emergjent dhe se dalja më e afërt, si dhe vendndodhja e saktë e pajisjeve kundër zjarrit, siç janë aparatet për fikjen e zjarrit, nuk janë të specifikuara. Për më tepër, nuk ka shenja të daljes fare në ndërtesë.

Nuk ekziston ndonjë procedurë udhëzuese emergjente për Galerinë e Arteve. Ky dokument do të ishte i rëndësishëm për t'u zbatuar, pasi që ndihmon në caktimin e personit përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e veprimeve që duhen ndërmarrë në rast zjarri, dhe gjithashtu ndihmon në përcaktimin paraprakisht se cilat do të jenë kanalet e komunikimit që do të përdoren në rast të një zjarri. Në thelb, ky dokument do të ndihmojë që të ketë një ide se cila do të jetë procedura që duhet ndjekur (duke qenë fleksibil) në rast zjarri, në mënyrë që të zvogëlohen pasojat e zjarrit sa më shumë që të jetë e mundur dhe për të siguruar një reagim të mirë. Megjithatë, sipas të intervistuarit, ekziston një pikë e mirë, pasi që komunikimi midis anëtarëve të stafit është i mirë. Është një shenjë e mirë për zbatimin e një plani të tillë që mund të testohet gjatë trajnimeve nga anëtarët e stafit.

Trajnimet

Sa u përket trajnimeve, asnjë anëtar i stafit nuk është trajnuar lidhur me rrezikun nga zjarri. Kjo do të thotë se askush nuk është trajnuar për evakuimin e njerëzve (vizitorëve) apo të artefakteve. Trajnimet dhe stërvitjet simuluese brenda ndërtesës dhe me përfshirjen e të gjithë anëtarëve të stafit nuk janë organizuar asnjëherë, dhe për këtë arsye nuk ekziston ndonjë rol i përcaktuar ndërmjet stafit në rast emergjence. Për më tepër, nuk ka bashkëpunim me zjarrfikësit, të cilët për këtë arsye nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në ndonjë stërvitje të simuluar në Muze dhe as nuk kanë njohuri specifike ose pajisje specifike për t'u ballafaquar me zjarret në Muze (që mund të zvogëlojë dëmin e panevojshëm nga uji në ndërtesat dhe gjësendet që gjenden në të gjatë ndërhyrjeve).

Siguria

Qasja në Galerinë e Arteve kontrollohet nga rojat e sigurisë dhe kamerat. Për më tepër, ndërtesa është e pajisur me sistem alarmi. Prandaj ndërtesa paraqet një nivel të lartë të sigurisë dhe është e përgatitur mirë për të parandaluar veprimet qëllimkëqija.

Koleksionet

Galeria ka një inventar të koleksioneve të saj. Të gjitha koleksionet janë të etiketuara e të dokumentuara dhe informacionet janë të digjitalizuara në një bazë të dhënash.

Përmbledhja e rezultateve

Galeria Kombëtare	Rrezikshmëria nga zjarri për shkollën...	
Ullët	Mjedisit	
Mesatare	Aspektit fizik të ndërtesës	
Ullët	Mungesës së mirëmbajtjes	
Ullët	Mungesës së qasjes	
Ullët	Mungesës së pajisjeve	
Lartë	Mungesës së trajnimeve	
Lartë	Mungesës së plan. emergjent	
Ullët	Mungesës së sigurisë	

Muzeu Etnografik i Gjakovës

Emri: **Muzeu Etnografik i Gjakovës**

Adresa: **Rr. "Yjet e Erenikut"**

Data e ndërtimit:

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Shtëpi tradicionale/Muze**

Pronari: **Ministria e Kulturës**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Lloji i arkitekturës: **Shtëpi tradicionale**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje elektrike**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu Etnologjik i Gjakovës financohet nga Komuna e Gjakovës dhe ka vetëm tre anëtarë të stafit. Sipas të intervistuarit, Muzeut i mungojnë burimet financiare dhe njerëzore për një funksionim optimal.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu Etnografik ndodhet në njërën prej rrugëve kryesore të qytetit të Gjakovës. Pavarësisht vendndodhjes së tij në qendër të qytetit dhe mungesës së një tampon zone rreth pronës së Muzeut, nuk ekziston ndonjë ndërtesë dhe infrastrukturë ndërhyrëse, sikurse janë linjat elektrike etj., si dhe rrugët nuk gjenden shumë afër ndërtesës së Muzeut. Prandaj burimet e jashtme të zjarrit që mund të përhapen dhe të kenë ndikim në Muze janë të kufizuara.

Vlerësimi i ceneshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu duket të jetë i mirëmbajtur mirë, duke e mirëmbajtur, pastruar shpesh. Muzeu është i vendosur në një shtëpi të vjetër tradicionale, përmban shumë materiale të ndezshme si druri, por edhe qilima dhe materiale prej pëllhurës. Sistemi i pajisjeve elektrike fatmirësisht është zëvendësuar me sistem të automatizuar, duke ulur rrezikun nga ndonjë fatkeqësi në këtë aspekt.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Ndërtesa nuk është lehtë e qasshme, sepse është e ndarë nga rruga, nga oborri dhe rrethoja. Dera hyrëse duket se është e mjaftueshme për të mundësuar hyrjen e kamionit të zjarrfikësve.

Për sa u përket pajisjeve kundër zjarrit, ndërtesa nuk ka asnjë sensor tymi dhe asnjë spërkatës. Qasja në ujë është paksa e vështirë, sipas të intervistuarit, por ekziston një hidrant i qytetit aty pranë. Në ndërtesë ka disa aparate për fikjen e zjarrit, që janë shumë të dukshme. Megjithatë, aparatet për fikjen e zjarrit testohen vetëm një herë në vit, kurse duhet testuar çdo gjashtë muaj. Ndërsa stafi menaxhues i Muzeut për këtë vit ka paraparë vendosjen e alarmit kundër zjarrit dhe rrufepritësit në ndërtesë.

Plani i evakuimit emergjent, planifikimi dhe trajnimet

Sikurse edhe muzetë e mësipërm të studiuar në këtë raport, as ky muze nuk ka një plan të evakuimit në rast të zjarrit, nuk ka shenja të daljes dhe nuk ka procedurë udhëzuese emergjente.

Mosekzistimi i një plani të evakuimit në rast të zjarrit do të thotë se nuk ka zona të caktuara për evakuim emergjent dhe se dalja më e afërt, si dhe vendndodhja e





saktë e pajisjeve kundër zjarrit, siç janë aparatet për fikjen e zjarrit, nuk janë të specifikuara. Për më tepër, nuk ka shenja të daljes fare në ndërtesë. Sa u përket trajnimeve, asnjë anëtar i stafit nuk është trajnuar lidhur me rrezikun nga zjarri dhe nuk ekziston asnjë bashkëpunim me zjarrfikësit.

Siguria

Qasja në Muze është e kontrolluar nga kamerat, të cilat janë vendosur rishitazi. Ndërtesa nuk ka asnjë rojë, si dhe nuk ka sistem alarmi. Sipas stafit menaxhues të Muzeut, për këtë vit është paraparë vendosja e sistemit të alarmit të sigurisë së ndërtesës.

Koleksionet

Muzeu ka një inventar të koleksioneve, dhe të gjitha artefaktet janë të etiketuara dhe të dokumentuara. Dokumentacioni është vetëm në letër dhe do të ishte ideale që të ketë gjithashtu edhe kopje elektronike në kompjuter (përndryshe, në rast se dokumentet prej letrës digjen gjatë ndonjë zjarri eventual, do të ketë shumë humbje të informatave).

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu etnografik i Gjakovës	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...	Ullët	Mjedisit
Mesatare	Aspektit fizik të ndërtesës	Ullët	Mungesës së mirëmbajtjes
Ullët	Mungesës së qasjes	Mesatare	Mungesës së pajisjeve
Lartë	Mungesës së trajnimeve	Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Mesatare	Mungesës së sigurisë		

Muzeu i Familjes Qerkezi – Muze Historik i Vitit 1999

Emri: **Shtëpia e Familjes Qerkezi: Muzeu Historik i Vitit '99**

Adresa: **Rr. "Anton Çeta"**

Data e ndërtimit: **1973-1976**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Shtëpi banimi/Muze**

Pronari/Lloji i pronësisë: **Private**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje elektrike**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**

SHTËPIA TRADICIONALE

E

FAMILJES QERKEZI

MUZEU HISTORIK

1999

Menaxhimi i ndërtesës

Ky muze është hapur nga Ferdonije Qerkezi në shtëpinë e saj për të përkujtuar bashkëshortin dhe katër djemtë e saj, si dhe viktimat e tjera të luftës së vitit 1999. Ferdonije Qerkezi jeton vetëm në këtë Shtëpi-Muze dhe kujdeset për Muzeun “e vogël” që ajo krijoi në shtëpinë e saj. Përveç disa vitrinave të xhamit të cilat ia siguroi Ministria e Kulturës, ajo e mirëmban personalisht, nga të hyrat vetjake këtë ndërtesë.

Informata në lidhje me zonën përreth

Ky është një muze shumë i veçantë i vendosur në një shtëpi banimi dhe në një zonë banimi të qytetit të Gjakovës. Shtëpia gjendet në afërsi të dy shtëpive të tjera, dhe kështu nëse ndizet ndonjë zjarr në njërin nga këto shtëpi mund të përhapet lehtësisht edhe në Muze.

Vlerësimi i cënueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Ndërtesa është e mirëmbajtur mirë, duke u mirëmbajtur, pastruar shpesh. Ndërtesa përmban materiale të ndezshme (qilima, materiale nga druri dhe pëlhura) dhe ekzistojnë burime të ndezjes (sidomos në kuzhinë, dhe për shkak të sistemit të vjetër elektrik i cili përbëhet nga kutia me siguresa prej porcelani). Prandaj rreziku nga zjarri nuk mund të injorohet dhe është aq i lartë sa në çdo shtëpi apo banesë të banuar. Sistemi elektrik duhet të zëvendësohet në mënyrë që të zvogëlohet ndjeshëm rreziku nga ndezja e zjarrit.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit, evakuimi emergjent dhe planifikimi

Ndërtesa është lehtë e qasshme për zjarrfikësit, pasi që ekziston një rrugë afër. Për sa u përket pajisjeve, nuk ka pajisje kundër zjarrit, si p.sh. sensorë tymi, spërkatës ose aparate për fikjen e zjarrit. Në rast zjarri, koha e reagimit (ekuivalent me thirrjen e zjarrfikësve dhe duke pritur për arritjen e tyre) mund të ndikojë në humbje të konsiderueshme.

Gjithashtu në këtë shtëpi-muze nuk ekziston ndonjë plan i evakuimit në rast të zjarrit dhe nuk ka ndonjë procedurë udhëzuese emergjente në ndërtesë, dhe Ferdonije Qerkezi nuk është trajnuar për t'u ballafaquar me situata të zjarrit.

Siguria

Sa i përket sigurisë, ndërtesa nuk është e pajisur me rojë ose me sistem alarmi, por ka një kamerë në hyrje të saj dhe qasja në shtëpi kontrollohet nga vetë pronarja.

Koleksionet

Koleksionet nuk janë të inventarizuara dhe nuk janë të dokumentuara. Megjithatë, ato janë të etiketuara.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu i familjes Qerkezi	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...
Ulët në mesatare	Mjedisit
Mesatare	Aspektit fizik të ndërtesës
Ulët	Mungesës së mirëmbajtjes
Ulët	Mungesës së qasjes
Lartë	Mungesës së pajisjeve
Lartë	Mungesës së trajnimeve
Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Mesatare	Mungesës së sigurisë

Muzeu Historik

Emri: **Muzeu Historik**

Adresa: **Çarshia e Madhe**

Data e ndërtimit: **Shekulli XVIII**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Shtëpi tradicionale/Muze**

Pronari: **Ministria e Kulturës**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Lloji i arkitekturës: **Shtëpi tradicionale**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes:

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Gjendja e Muzeut Historik të Gjakovës është pak a shumë si e Muzeut Etnografik të Gjakovës: aty mungojnë burimet njerëzore dhe ato financiare, ku ky muze funksionon me vetëm një anëtar të stafit. Ndërtesa, e cila është një shtëpi tradicionale, paraqet disa materiale të ndezshme si druri. Qasshmëria për zjarrfikësit është relativisht e lehtë, por ka mungesë të pajisjeve kundër zjarrit, sikurse janë sensorët për fikjen e zjarrit. Ndërtesa është e pajisur me aparate për shuarjen e zjarrit.

Edhe këtu nuk ekziston ndonjë plan evakuimi, udhëzues për raste emergjence ose trajnime për anëtarët e stafit.

Sa i përket sigurisë, qasja kontrollohet gjatë ditës, por nuk ka asnjë rojë dhe asnjë sistem alarmi. Megjithatë, ndërtesa është e pajisur me kamera të sigurisë.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu historik	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...	N/A	Mjedisit
Mesatare në të lartë	Aspektit fizik të ndërtesës	N/A	Mungesës së mirëmbajtjes
Ulët	Mungesës së qasjes	Lartë	Mungesës së pajisjeve
Lartë	Mungesës së trajnimeve	Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Lartë	Mungesës së sigurisë		

Muzeu Etnografik i Pejës

Emri: **Muzeu Etnografik i Pejës (Konaku i Tahir Begut)**

Adresa: **Sheshi Haxhi Zeka**

Data e ndërtimit: **Rreth vitit 1800**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Shtëpi tradicionale/Muze**

Pronari: **Ministria e Kulturës**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Lloji i arkitekturës: **Shtëpi tradicionale**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje elektrike**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu Etnografik në Pejë financohet nga Komuna e Pejës. Ekipi që punon aty përbëhet nga 6 anëtarë. Megjithëse ekipi është relativisht i vogël, i intervistuari ishte i mendimit se ky muze ka burime të mjaftueshme njerëzore për funksionimin e mirë të tij, por anëtarët e stafit të intervistuar shprehen se kanë mungesë të burimeve financiare

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu ndodhet afër një rruge kryesore të Pejës. Ambienti i Muzeut është i pastër, por një pompë derivatesh ndodhet shumë afër Muzeut dhe mund të konsiderohet si një ndërtesë ndërhyrëse. Ajo paraqet një rrezik për Muzeun, veçanërisht për shkak të funksionimit të kësaj ndërtese ndërhyrëse.

Vlerësimi i cenueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu është i mirëmbajtur mirë, duke u pastruar shpesh. Ndërtesa ka materiale të ndezshme, siç është druri dhe materiale prej pëlhurës. Ka edhe shumë qilima në dhomat e ndryshme të ekspozitës. Për më tepër, sistemi elektrik është i vjetër dhe nuk ka gjenerator. Sistemi elektrik mund të shihet si një burim i mundshëm i ndezjes dhe duhet të zëvendësohet me një sistem më modern. Pirja e duhanit është e ndaluar në ndërtesë.

I intervistuari tha se bëhen inspektime të rregullta të ndërtesës, por elementet elektrike nuk fiken gjithmonë edhe kur ato nuk përdoren. Kjo rrit rrezikun e ndezjes së ndonjë zjarri, veçanërisht për shkak të sistemit elektrik të vjetër dhe të pasigurt.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Ndërtesa është e lehtë për t'u qasur nga zjarrfikësit, pasi që ka një rrugë kryesore aty pranë. Sidoqoftë, ka shumë parkingje veturash në rrethinat e ndërtesave dhe ato ndonjëherë pengojnë qasjen në ndërtesë. Për më tepër, rruga zakonisht është e mbushur me vetura. Prandaj qasja nuk është optimale.

Sa u përket pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri, nuk ka sensorë të tymit dhe nuk ka asnjë spërkatës në ndërtesë. Nuk ka as edhe hidrantë në ndërtesë, por ka një qasje të lehtë në ujë. Ndërtesa është e pajisur me aparate për fikjen e zjarrit, por nuk janë të vendosura në vende të dukshme. Për më tepër, pajisjet për mbrojtje nga zjarri testohen vetëm një herë në vit, kurse duhet të testohen çdo gjashtë muaj.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi, trajnimet

Nuk ekziston ndonjë plan evakuimi në Muze që tregon rrugët e emergjencës dhe daljet, por një shenjë e vendosur në një mur tregon se ku është dalja.

Ngjashëm sikurse edhe në muzetë e tjerë për të cilët është bërë vlerësimi,





stafi nuk është i trajnuar dhe nuk ka ndonjë bashkëpunim me zjarrfikësit, si dhe nuk ka udhëzues të procedurave emergjente.







Siguria

Qasja në Muze nuk është e kontrolluar siç duhet, pasi nuk ka rojë, nuk ka as kamera dhe as sistem alarmi. Prandaj cënueshmëria e Muzeut ndaj veprimeve qëllimkëqija është e lartë, pasi nuk ka masa të mjaftueshme të ndërmarra lidhur me sigurinë.

Koleksionet

Një bazë të të dhënash përdoret për të inventarizuar koleksionin. Artefaktet janë të etiketuara dhe të dokumentuara.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu Etnografik i Pejës	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...	Mjedisit	Mesatare	
Mesatare	Mjedisit	Aspektit fizik të ndërtesës	Mesatare	
Ulët në mesatare	Mungesës së mirëmbajtjes	Mungesës së qasjes	Ulët në mesatare	
Mesatare	Mungesës së pajisjeve	Mungesës së trajnimeve	Mesatare	
Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent	Mungesës së sigurisë	Lartë	
Lartë	Mungesës së sigurisë		Lartë	

Muzeu Arkeologjik

Emri: **Muzeu Arkeologjik**

Adresa: **Rr. "Sahat Kulla", Prizren**

Data e ndërtimit: **Hamami (1498), Sahat Kulla (1868)**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Hamami është rikthyer në muze**

Pronari: **Ministria e Kulturës**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Materiali i ndërtimit: **Gurë**

Ventilimi: **Natyor**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje elektrike**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu Arkeologjik i Prizrenit financohet nga Ministria e Kulturës. Ky muze ka të punësuar vetëm dy punonjës, dhe i intervistuari thotë që nuk ka staf të mjaftueshëm që punojnë në Muze. Sidoqoftë, ai shprehet se ka fonde të mjaftueshme sa për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e mirë të Muzeut.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu ndodhet në një rrugë të vogël ku ndërtesat janë shumë afër njëra-tjetrës. Rrjedhimisht, ekzistojnë disa infrastruktura ndërhyrëse të tilla si linjat elektrike të cilat janë shumë afër Muzeut. Megjithatë, nuk ka ndonjë ndërtesë ndërhyrëse dhe lokacioni, si dhe mjedisi përreth janë të pastra.

Vlerësimi i cënueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu është i mirëmbajtur mirë, duke u pastruar shpesh. Ndërtesa është e ndërtuar nga gurët dhe nuk ka materiale të ndezshme, përveç sahat kullës që ka disa pjesë druri. Pirja e duhanit është e ndaluar në ndërtesë.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Ndërtesa është relativisht e lehtë për t'u qasur nga zjarrfikësit, pasi që ekziston një rrugë afër. Ndërtesën kryesore e ndan nga rruga oborri i saj. Nuk ka shumë komunikacion rrugor, por një veturë e parkuar keq mund të pengojë qasjen në ndërtesë, pasi që rruga është e ngushtë.

Lidhur me pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, nuk ka sensorë të tymit dhe nuk ka spërkatës në ndërtesë. Megjithatë, ekziston një hidrant në ndërtesë dhe një qasje e lehtë në ujë. Ndërtesa është e pajisur me aparate për fikjen e zjarrit, që mund të gjenden lehtë në Muze dhe që testohen çdo 6 muaj.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi, trajnimet

Nuk ekziston ndonjë plan evakuimi në Muze që tregon rrugët e emergjencës dhe daljet, ngjashëm me muzetë e tjerë. Megjithatë, stafi është i trajnuar për të evakuuar njerëzit dhe për të lëvizur artefaktet.








Siguria

Qasja në Muze kontrollohet në mënyrën e duhur. Muzeu ka kamera dhe sistem alarmi.

Koleksionet

Koleksionet e Muzeut janë të etiketuara dhe të dokumentuara. Ekziston një inventar i të gjitha artefakteve në formë të dokumenteve fizike që aktualisht po digjitalizohet

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu Arkeologjik i Prizrenit	Rrezikshmëria nga zjarri për shkaktë...	
Ullët në mesatare	Mjedisit	
Ullët në mesatare	Aspektit fizik të ndërtesës	
Ullët	Mungesës së mirëmbajtjes	
Ullët	Mungesës së qasjes	
Mesatare Lartë	Mungesës së pajisjeve	
Ullët	Mungesës së trajtimit	
	Mungesës së planifikimit emergjent	

Muzeu Etnologjik i Prizrenit

Emri: **Muzeu Etnologjik i Prizrenit**

Adresa: **Rr. "Bujar Godeni", nr. 19, Prizren**

Data e ndërtimit: **Shekulli XIX**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Shtëpi tradicionale/Muze**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje elektrike**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu Etnologjik i Prizrenit merr disa fonde nga Ministria e Kulturës. Ka shtatë persona që punojnë në Muze. Sipas të intervistuarit, ka mjaft burime njerëzore, por jo mjaft burime financiare.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu ndodhet në një rrugë të vogël ku ndërtesat janë shumë afër njëra me tjetrën. Rrjedhimisht, ekzistojnë disa infrastruktura ndërhyrëse të tilla si linjat elektrike, të cilat janë shumë afër Muzeut. Megjithatë, nuk ka ndonjë ndërtesë ndërhyrëse dhe lokacioni, si dhe mjedisi përreth janë të pastra.

Vlerësimi i cenueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu është i mirëmbajtur mirë, duke u pastruar shpesh. Ndërtesa, e cila është një shtëpi tradicionale, përmban shumë dru, si dhe materiale prej pëlhurës, të cilat janë materiale lehtësisht të ndezshme. Pirja e duhanit është e ndaluar në ndërtesë.

Qasja dhe sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Ndërtesa është relativisht e lehtë për t'u qasur nga zjarrfikësit pasi që ekziston një rrugë afër. Ndërtesën kryesore e ndan nga rruga oborri i saj. Nuk ka shumë komunikacion rrugor, por një veturë e parkuar keq mund të pengojë qasjen në ndërtesë, pasi që rruga është e ngushtë.

Lidhur me pajisjet e mbrojtjes nga zjarri; nuk ka spërkatës në ndërtesë, por ka sensorë tymi, hidrantë në ndërtesë dhe një qasje të lehtë në ujë. Ndërtesa është e pajisur me aparate për fikjen e zjarrit, që janë të vendosura në vende jo të dukshme. Ato testohen çdo 6 muaj.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi, trajnime

Nuk ekziston ndonjë plan evakuimi në Muze që tregon rrugët e emergjencës dhe daljet. Ngjashëm sikurse edhe me muzetë e tjerë për të cilët është bërë vlerësimi, stafi nuk është i trajnuar dhe nuk ka ndonjë bashkëpunim me zjarrfikësit, si dhe nuk ka udhëzues të procedurave emergjente.

Siguria

Sa i përket sigurisë, Muzeu është i pajisur me kamera dhe sistem alarmi, por nuk ka kontroll për qasje dhe nuk ka rojë. Duhet bërë disa përmirësime.

Koleksionet

Koleksionet e Muzeut janë të etiketuara dhe të dokumentuara. Ekziston një inventar i të gjitha artefakteve në një bazë të dhënash elektronike.



Përmbledhja e rezultateve

Muzeu Etnografik i Prizrenit	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...
Ullët në mesatare	Mjedisit
Mesatare në të lartë	Aspektit fizik të ndërtesës
Ullët	Mungesës së mirëmbajtjes
Ullët	Mungesës së qasjes
Ullët	Mungesës së pajisjeve
Lartë	Mungesës së trajnimeve
Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Mesatare	Mungesës së sigurisë

Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Emri: **Lidhja Shqiptare “Lidhja e Prizrenit”**

Adresa: N/A

Data e ndërtimit: **Rreth vitit 1878**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Ndërtesë historike/ Muze**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Rregullorja e Brendshme**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje elektrike**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Lidhja Shqiptare është një ndërtesë historike që u shndërrua në një muze. Financohet nga Ministria e Kulturës dhe ka 10 anëtarë të stafit që punojnë aty. Sipas të intervistuarve, ka mjaft burime njerëzore por nevojiten më shumë burime financiare për të siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e mirë të Muzeut.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu është pjesë e një kompleksi më të madh dhe nuk ka ndërtesa ndërhyrëse, si dhe nuk ka infrastrukturë tjetër (si linjat elektrike) rreth Muzeut. Ambienti dhe ndërtesa në tërësi janë të pastër (nuk ka mbeturina në tokë, dysheme).

Ngjarjet e mëparshme

Ndryshe nga ndërtesat e tjera që janë vlerësuar në Raport, ndërtesa u shkatërrua krejtësisht për shkak të zjarrit gjatë luftës së viteve 1998–1999. Ajo u rindërtua në qershor të vitit 2000.

Vlerësimi i cenueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu është i mirëmbajtur mirë, duke u pastruar shpesh. Ndërtesa, e cila është një shtëpi tradicionale, përmban shumë dru, si dhe materiale prej pëlhurës, të cilat janë materiale lehtësisht të ndezshme. Pirja e duhanit është e ndaluar në ndërtesë.

Gjatë kohës kur e vizituam këtë muze, ai ishte duke u rinovuar. Masa të posaçme ishin marrë për të kufizuar rrezikun nga zjarri.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Ndërtesa është relativisht e lehtë për t'u qasur nga zjarrfikësit, pasi që ekziston një rrugë afër. Ndërtesën kryesore e ndan nga rruga oborri i saj. Nuk ka shumë komunikacion rrugor.

Lidhur me pajisjet e mbrojtjes nga zjarri: nuk ka spërkatës në ndërtesë, por ka sensorë tymi, hidrantë në ndërtesë dhe një qasje të lehtë në ujë. Ndërtesa është e pajisur me aparate për fikjen e zjarrit, që janë të dukshme, dhe ato testohen çdo 6 muaj.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi

Nuk ekziston ndonjë plan evakuimi në Muze që tregon rrugët e emergjencës dhe daljet. Ngjashëm sikurse edhe me muzetë e tjerë, për të cilët është bërë vlerësimi, nuk ka udhëzues të procedurave emergjente.



Trajnimet

Shumica e anëtarëve të stafit nuk janë të trajnuar për t'u ballafaquar me evakuimin emergjent, por njëri nga anëtarët e stafit është trajnuar 8 vjet më parë për të mësuar se si evakohen njerëzit dhe artefaktet në rast zjarri. Sidoqoftë, ajo që ky anëtar i stafit ka mësuar gjatë këtij trajnimi nuk u shpërnda me anëtarët e tjerë të stafit dhe trajnimet nuk janë kryer që atëherë. Për më tepër, nuk ekziston ndonjë bashkëpunim i themeluar me zjarrfikësit.

Siguria

Muzeu është i siguruar mirë me hyrje të kontrolluar, rojë, kamera dhe sistem alarmi.

Koleksionet

Koleksionet e Muzeut janë të etiketuara dhe të dokumentuara. Ato janë të inventarizuara në dokumente fizike (letër).

Koleksionet nuk lëvizeshin shpesh, por duhej të lëvizeshin për shkak të punëve rinovuese. Prandaj koleksionet tani gjenden në Muzeun Arkeologjik në mënyrë që të sigurojnë një mbrojtje më të mirë të artefakteve të ndryshme. Ato janë transportuar duke përdorur kuti të posaçme për t'i siguruar gjatë bartjes.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu Etnografik i Pejës	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...	Ulët	Mjedisit
Ulët	Ulët në mesatare	Ulët	Mungesës së mirëmbajtjes
Ulët	Ulët	Ulët	Mungesës së qasjes
Ulët	Mesatare në të lartë	Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Ulët			Mungesës së sigurisë

Muzeu i qytetit të Ferizajit

Emri: **Muzeu i Ferizajt**

Adresa: **Sheshi Naim Beka**

Data e ndërtimit: **1937**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Qendër Kulturore, Galeri e Arteve dhe Muze**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nuk është i mbrojtur**

Instrumentet ligjore: **Rregullore e Brendshme**

Ventilimi: **Natyror**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu i Ferizajt ndodhet në një qendër kulturore. Ai financohet nga Komuna dhe ka vetëm një anëtar të stafit që punon në të. Sipas të intervistuarit, nuk ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe nuk ka fonde të mjaftueshme.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu ndodhet brenda qendrës kulturore, nuk ka ndonjë ndërtesë ndërrhyrëse dhe ndonjë infrastrukturë të veçantë që ndodhet afër Muzeut. Sidoqoftë, ka një apartament banimi pikërisht mbi dhomën kryesore të Muzeut. Ai paraqet një kërcënim të jashtëm të rëndësishëm nëse ndizet ndonjë zjarr në këtë apartament. Në të kaluarën nuk ka pasur ndonjë zjarr, por disa dëme nga uji të shkaktuara nga ky apartament.

Vlerësimi i cenueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu nuk ka ndonjë cenueshmëri të veçantë ndaj zjarrit në lidhje me materialin e tij ndërtimor. Vetëm koleksionet paraqesin disa materiale të ndezshme, si druri dhe pëlhura. Në përgjithësi, Muzeu duket se është i mirëmbajtur mirë.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Muzeu është i qasshëm lehtë nga zjarrfikësit dhe ka tri dalje emergjente (por jo të specifikuar me shenja dalëse). Sa u përket pajisjeve të saj kundër zjarrit, nuk ka sensorë të tymit dhe nuk ka spërkatës në muze, por ka një qasje të lehtë në ujë, si dhe ka hidrant të ndërtesës. Muzeu është i pajisur me aparate për fikjen e zjarrit, por ato nuk janë të dukshme në lokacionet e ekspozitave, si dhe në pjesën tjetër të Muzeut. Për më tepër, ato testohen vetëm një herë në vit.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi, trajnimi i stafit

Sikurse edhe shumica e muzeve të vlerësuar, as ky muze nuk ka plan evakuimi e as udhëzues për procedurat emergjente, dhe stafi nuk është i trajnuar për t'u ballafaquar me situata emergjente. Sidoqoftë, është themeluar një bashkëpunim me zjarrfikësit dhe atë për shkak të dëmeve të ujit të shkaktuara nga apartamenti i vendosur mbi Muze.

Siguria

Muzeu është i siguruar pjesërisht, me një qasje të kontrolluar dhe me praninë e rojave, por jo gjatë gjithë kohës brenda ditës. Ka kamera të sigurisë, por Muzeu nuk është i pajisur me sistem alarmi.



**NDALOHET
PIRJA E DUHANIT**

Koleksionet

Sa u përket koleksioneve, është bërë një inventarizim i artefakteve. Artefaktet janë të etiketuara dhe të dokumentuara dhe dokumenti është i qasshëm në format letre.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu i qytetit të Ferizajt	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...	Mjedisit	Mesatare	
Ulët	Aspektit fizik të ndërtesës			
Ulët	Mungesës së mirëmbajtjes			
Ulët	Mungesës së qasjes			
Mesatare	Mungesës së pajisjeve			
Lartë	Mungesës së trajtimeve			
Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent			
Mesatare	Mungesës së sigurisë			

Muzeu i Gjilanit

Emri: **Muzeu i Gjilanit**

Adresa: **Rr. "Adem Jashari"**

Data e ndërtimit: **Gjysma e dytë e shekullit XIX**

Lloji i arkitekturës: **Ndërtesë Austro-Hungareze**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Qendër Rajonale e Kulturës/ Muze**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje qendrore**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu i Gjilanit financohet nga Ministria e Kulturës dhe nga Komuna e Gjilanit. I vendosur në të njëjtën ndërtesë me Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Gjilan, nuk ka ndonjë anëtar të duhur të stafit. Prandaj i intervistuari ankohet për mungesë të burimeve njerëzore dhe të atyre financiare për të siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e mirë të Muzeut.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu ndodhet në qendër të Gjilanit. Edhe pse nuk ka ndonjë tampon zonë rreth pronës, nuk ka ndonjë ndërtesë ndërhyrëse në rrethinë. Megjithatë, disa infrastruktura (sidomos linjat elektrike) si dhe rruga janë afër Muzeut. Në përgjithësi, burimet e jashtme të zjarrit që mund të përhapen dhe të ndikojnë në Muze mbesin të kufizuara.

Vlerësimi i cënueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu përmban koleksione të rëndësishme të artefakteve të ndërtuara nga druri ose pëlhura. Prandaj ka materiale të ndezshme në dhomat e ndryshme të Muzeut. Ndërtesa duket se mirëmbahet mirë, si dhe pastrimi i Muzeut bëhet rregullisht.

Qasja dhe sistemi i sigurisë kundër zjarrit dhe pajisjet

Për shkak të afërsisë me rrugën kryesore, ndërtesa është lehtësisht e qasshme nga zjarrfikësit. Sidoqoftë, komunikacioni rrugor mund të jetë i rëndësishëm pasi që veturat nganjëherë parkohen keq përreth Muzeut, gjë që mund të ngadalësojë ose të pengojë ndërhyrjen e zjarrfikësve në rast zjarri.

Lidhur me pajisjet kundër zjarrit, Muzeu nuk ka sensor të tymit dhe nuk ka spërkatës. Ekzistojnë dy aparate për fikjen e zjarrit në ndërtesë, por ato janë të vjetra dhe nuk duket se funksionojnë. Për më tepër, ato nuk janë testuar.

Nga ana pozitive, ndërtesa është e pajisur me hidrant dhe ka një qasje të lehtë në ujë. Për më tepër, pirja e duhanit është e ndaluar në të gjithë ndërtesën.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi, trajnimi i stafit

Sikurse edhe shumica e muzeve të vlerësuar, as ky muze nuk ka plan evakuimi e as udhëzues për procedurat emergjente dhe stafi nuk është i trajnuar për t'u ballafaquar me situata emergjente.

Siguria

Muzeu është i siguruar pjesërisht, me një qasje të kontrolluar të pjesshme dhe me praninë e rojave, por jo gjatë gjithë kohës brenda ditës. Ka kamera të sigurisë, por nuk është i pajisur me sistem alarmi.

Koleksionet

Sa u përket koleksioneve, është bërë inventarizimi i artefakteve. Artefaktet janë të etiketuara dhe të dokumentuara (ekziston një formular për secilin artefakt).

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu i Qytetit të Gjilanit	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...
Ujët në mesatare	Mjedisit
Ujët	Aspektit fizik të ndërtesës
Ujët	Mungesës së mirëmbajtjes
Ujët	Mungesës së qasjes
Mesatare	Mungesës së pajisjeve
Lartë	Mungesës së trajnimeve
Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Mesatare	Mungesës së sigurisë

Muzeu i Mitrovicës

Emri: **Muzeu i Mitrovicës**

Adresa: **Rr. "Shemsi Ahmeti", Mitrovicë**

Data e ndërtimit: **1959**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Shtëpi e Armatës/ Muze dhe Shkollë e Muzikës**

Pronari: **Ministria e Kulturës**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nën Mbrojtje të Përkohshme**

Instrumentet ligjore: **Ligji për Trashëgiminë Kulturore**

Lloji i arkitekturës: **Shtëpi tradicionale**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrohje qendrore**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**

SHKOLLA FILLORE, E MESME E UJËT DHE E MESME E LARTË FIZIKË DHE
"TEFTA TASHKO"
MITROVICË



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu i Mitrovicës financohet nga Kuvendi Komunal. Ka njëmbëdhjetë persona që punojnë në Muze. Sipas të intervistuarit, ka mjaft burime njerëzore, por jo edhe burime të mjaftueshme financiare.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu ndodhet në qendër të qytetit të Mitrovicës dhe nuk ka ndërtesa ndërhyrëse, si dhe nuk ka infrastrukturë tjetër (si linjat elektrike) rreth tij. Ambienti dhe ndërtesa në tërësi janë të pastër.

Vlerësimi i cënueshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu është i mirëmbajtur mirë, duke u pastruar shpesh. Ndërtesa akomodon dy institucione brenda saj. Në përdhese gjendet Muzeu i Mitrovicës, përderisa kati i sipërm shfrytëzohet si Shkollë e Muzikës. Të dyja e shfrytëzojnë hyrjen e njëjtë. Është e ndaluar pirja e duhanit në ndërtesë.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Ndërtesa është relativisht e lehtë për t'u qasur nga zjarrfikësit, pasi që ekziston një rrugë afër. Ndërtesën kryesore e ndan nga rruga oborri i saj. Hyrja në oborr është e kontrolluar dhe brenda tij me veturë mund të qasen vetëm personat e autorizuar.

Lidhur me pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, ndërtesa ka hidrantë dhe një qasje të lehtë në ujë, por nuk ka sensorë të tymit. Ajo është e pajisur me aparate për fikjen e zjarrit dhe ato janë në vende të dukshme. Ato testohen çdo 6 muaj. Ka, po ashtu, edhe rrufepritës, mirëpo nuk dihet nëse funksionon.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi, trajnimet

Nuk ekziston ndonjë plan evakuimi në Muze që tregon rrugët e emergjencës dhe daljet. Ngjashëm sikurse edhe muzetë e tjerë për të cilët është bërë vlerësimi, stafi nuk është i trajnuar dhe nuk ka udhëzues të procedurave emergjente.

Siguria

Sa i përket sigurisë, Muzeu nuk është i pajisur me kamera dhe sistem alarmi, por ka kontroll për qasje dhe rojë. Rrezik për Muzeun mund të jetë ndarja e ndërtesës me Shkollën e Muzikës, meqë ekziston rreziku që të shkaktohet ndonjë fatkeqësi nga pakujdesia e nxënësve





Koleksionet

Koleksionet e Muzeut janë të etiketuara dhe të dokumentuara. Ekziston një inventar i të gjitha artefakteve i cili është bërë në të kaluarën, ndërsa tani ka filluar edhe riinventarizimi i tyre.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu i Mitrovicës	Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...
Ullët	Mjedisit
Mesatare në të lartë	Aspektit fizik të ndërtesës
Ullët	Mungesës së mirëmbajtjes
Ullët	Mungesës së qasjes
Mesatare	Mungesës së pajisjeve
Lartë	Mungesës së trajnimeve
Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Mesatare	Mungesës së sigurisë

Muzeu i Kristaleve në Stantërg

Emri: **Muzeu i Kristaleve në Stantërg**

Adresa: **Rg. "Shemsi Ahmeti", Mitrovicë**

Data e ndërtimit: **2012**

Lloji i ndërtesës/përdorimi: **Muze**

Lloji i pronësisë: **Publike**

Lloji i mbrojtjes: **Nuk është i mbrojtur**

Instrumentet ligjore: **Ligji i punës**

Ventilimi: **Natyror**

Lloji i sistemit të ngrohjes: **Ngrrohje elektrike (Ka të instaluar edhe ngrohje qendrore, por është e patestuar dhe jashtë përdorimit)**

Ngjarjet e mëparshme (zjarr): **Jo**



Menaxhimi i ndërtesës

Muzeu i Kristaleve financohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Ka tetë persona që punojnë në Muze. Sipas të intervistuarit, Muzeu nuk ka burime të mjaftueshme njerëzore e as financiare. Sa i përket aspektit financiar, Muzeu nuk ka buxhet të vetin. Pagat paguhen drejtpërdrejt nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe nuk kanë të hyra nga burime të tjera. Rrjedhimisht, për çfarëdo shpenzimi lidhur me Muzeun kërkesa duhet drejtuar MZHE-së, përmes procedurave mjaft burokratike. Si pasojë e kësaj, menaxhimi me ndërtesën është relativisht i vështirë.

Informata në lidhje me zonën përreth

Muzeu ndodhet brenda oborrit të Minierës së “Trepçës”, në Stantërg. Ndërtesa e Muzeut ndodhet në një pozitë shumë të mirë brenda oborrit, me hapësirë të mjaftueshme gjelbëruese para saj, e shoqëruar me një amfiteatër të vogël. Nuk ka asnjë ndërtesë ndërhyrëse. Lokacioni dhe mjedisi përreth tij janë të pastër.

Vlerësimi i ceneshmërisë “fizike” dhe mirëmbajtja

Muzeu është i mirëmbajtur mirë. Materiali i ndërtimit është kryesisht nga betoni, me dysheme qeramike dhe nuk ka ndonjë rrezik të ndezjes. Pirja e duhanit është e ndaluar në ndërtesë.

Qasja, sistemi i sigurisë dhe pajisjet kundër zjarrit

Ndërtesa është relativisht e lehtë për t’u qasur nga zjarrfikësit. Ndërtesën kryesore e ndan nga rruga oborri i saj. Hyrja në oborr është e kontrolluar dhe brenda tij me veturë mund të qasen vetëm personat e autorizuar.

Lidhur me pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, ndërtesa ka hidrant të ujit dhe një qasje të lehtë në ujë, por nuk ka aparate për fikjen e zjarrit. Ajo është e pajisur me sensor për detektimin e tymit, si dhe sistem të ventilimit, mirëpo ato nuk janë të testuara.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi, trajnimet

Nuk ekziston ndonjë plan evakuimi në Muze që tregon rrugët e emergjencës dhe daljet. Ngjashëm sikurse edhe muzetë e tjerë për të cilët është bërë vlerësimi, stafi nuk është i trajnuar dhe nuk ka ndonjë bashkëpunim me zjarrfikësit, si dhe nuk ka udhëzues të procedurave emergjente.

Siguria


Sa i përket sigurisë, muzeu është i pajisur me kamera dhe sistem alarmi, dhe ka edhe kontroll për qasje dhe rojë. Për shkak se Muzeu gjendet në oborrin e Minierës së “Trepçës”, kjo e rritë edhe më tepër aspektin e sigurisë së ndërtesës.

Koleksionet

Koleksionet e Muzeut janë të etiketuara dhe të dokumentuara. Ekziston një inventar i të gjitha artefakteve në një bazë të dhënash elektronike.

Përmbledhja e rezultateve

Muzeu i Kristaleve	Rreziqshmëria nga zjarri për shkak të...
Ujë	Mjedis
Ujë	Aspekti fizik të ndërtesës
Ujë	Mungesës së mirëmbajtjes
Ujë	Mungesës së qasjes
Mesatare	Mungesës së pajisjeve
Lartë	Mungesës së trajnimeve
Lartë	Mungesës së planifikimit emergjent
Ujë	Mungesës së sigurisë



Rrezikshmëria nga zjarri për shkak të...	Mjedisit	Aspektit fizik të ndërtesës	Mungesës së mirëmbajtjes	Mungesës së qasjes së pajisjeve	Mungesës së trajnimit	Mungesës së planifikimit emergjent
Muzeu i Kosovës	Ujë	Ujë	Ujë	Mesatare	Lartë	Lartë
Galeria Kombëtare	Ujë	Mesatare	Ujë	Ujë	Lartë	Lartë
Muzeu Etnografik i Gjakovës	Ujë	Mesatare to Lartë	Ujë	Mesatare	Lartë	Lartë
Muzeu i Familjes Qerkezi	Ujë në Mesatare	Mesatare	Ujë	Lartë	Lartë	Mesatare
Muzeu Historik	N/A	Mesatare to Lartë	N/A	Lartë	Lartë	Lartë
Muzeu Etnografik i Pejës	Mesatare	Mesatare to Lartë	Ujë në Mesatare	Ujë	Lartë	Lartë
Muzeu Arkeologjik i Prizrenit	Ujë në Mesatare	Ujë në Mesatare	Ujë	Mesatare	Mesatare	Lartë
Muzeu Etnografik i Prizrenit	Ujë në Mesatare	Mesatare to Lartë	Ujë	Ujë	Lartë	Mesatare
Lidhja Shqiptare e Prizrenit	Ujë	Ujë në Mesatare	Ujë	Ujë	Mesatare	Lartë
Muzeu i qytetit të Ferizajt	Mesatare	Ujë	Ujë	Mesatare	Lartë	Mesatare
Muzeu i qytetit të Gjilanit	Ujë në Mesatare	Ujë	Ujë	Mesatare	Lartë	Mesatare
Muzeu i Mitrovicës	Ujë	Mesatare në të lartë	Ujë	Ujë	Lartë	Lartë
Muzeu i Kristaleve	Ujë	Ujë	Ujë	Mesatare	Lartë	Lartë

4

Përfundimi dhe rekomandimet

Pas realizimit të vëzhgimeve dhe intervistave të kryera në muze të ndryshëm, u identifikuan disa prirje të përgjithshme në muzetë e Kosovës. Ky kapitull paraqet konkluzionet e përgjithshme që janë nxjerrë në nivel kombëtar në lidhje me situatën e rrezikut nga zjarri në muzetë e Kosovës. Për më tepër, janë formuluar disa rekomandime që do t'iu ndihmonin muzeve në Kosovë për të përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre ndaj zjarrit.

Menaxhimi

Disa muze kanë shumë pak anëtarë të stafit dhe mungesa e burimeve njerëzore zakonisht vihet në dukje nga anëtarët e stafit. Megjithatë, çështja më e madhe në shumicën e muzeve duket të jetë mungesa e burimeve financiare. Kjo mund të shpjegojë pjesërisht mungesën e pajisjeve kundër zjarrit në disa muze apo pse sistemet e vjetra elektrike nuk janë zëvendësuar.

Kërcënimet e jashtme dhe qasshmëria

Muzetë e vlerësuar nuk kanë një tampon zonë, edhe pse janë nën mbrojtje të përkohshme. Zakonisht nuk ka ndërtesa ndërhyrëse dhe afërsia e infrastrukturave të tilla, si linjat elektrike, është më e lidhur me vendndodhjen gjeografike të muzeve në zonat urbane. Shumica e objekteve të këtyre muzeve ishin të pastra, por nuk është gjë e rrallë për të gjetur mbeturina në tokë nëpër rrugët e qyteteve të ndryshme të Kosovës. Mbeturinat e hedhura në tokë mund të jenë një burim i mundshëm zjarri. Muzetë zakonisht janë të lehtësisht të qasshëm për zjarrfikësit në raste zjarri. Megjithatë, qasja ndonjëherë mund të jetë e ndërlikuar për shkak të komunikacionit rrugor të dendur në shumicën e qyteteve kosovare (sidomos në kryeqytet). Për më tepër, veturat e parkuara në ambientet përreth muzeve ndonjëherë e pengojnë qasjen në ndërtesë.

Rekomandimet:

- Të krijohen dhe zbatohen tampon zonat rreth muzeve të ndryshëm, për të siguruar që të mos ketë në të ardhmen ndërtime ndërhyrëse.
- Stafi jo vetëm që duhet të sigurohet që ndërtesa e muzeut të jetë e pastër, por duhet të kontrollojë edhe rrugët në rrethinën e tij dhe të largojë mbeturinat nëse ka ndonjë.
- Përfundimisht, parkimi duhet të ndalohet në disa pika strategjike përreth muzeut, për t'u siguruar që asnjë veturë nuk e pengon qasjen në muze për zjarrfikësit në rast zjarri.
- Qasja duhet të kontrollohet së bashku me zjarrfikësit dhe duhet të gjendet një zgjidhje me ta, në mënyrë që të sigurohet një qasje e mirë në ndërtesë në rast zjarri për automjetin e zjarrfikësve.

Cenueshmëria “fizike”

Shumica e muzeve në Kosovë përmbajnë shumë materiale të ndezshme, veçanërisht muzetë etnologjike dhe ata etnografikë. Në të vërtetë, shumë artefakte tradicionale janë bërë nga druri apo pëlhura. Për më tepër, shumë prej muzeve ndodhen në shtëpi të vjetra tradicionale nga druri, si një nga materialet kryesore ndërtimore. Prandaj

cenueshmëria mund të jetë e lartë në disa muze, për shkak të këtyre aspekteve. Përveç kësaj, disa muze kanë sisteme të vjetra elektrike, që mund të jenë një burim i mundshëm zjarri, dhe kështu rrisin probabilitetin e ndezjes së zjarrit. Pirja e duhanit është e ndaluar në çdo muze, përveç në Shtëpinë e Familjes Qerkezi

Rekomandimi:

■ Të zëvendësohen sistemet e vjetra elektrike me sisteme më moderne dhe të sigurta elektrike.

■ Të sigurohet që drita (që mund të nxehë) ose elementët e tjerë elektrikë të largohen nga artefaktet prej drurit dhe atyre prej pëlhure.

■ Të sigurohet që të gjithë elementët elektrikë të fiken kur nuk përdoren (shpesh edhe bëhet kjo).

Sistemi i sigurisë kundër zjarrit dhe pajisjet

Ekzistojnë shumë kontraste në lidhje me pajisjet kundër zjarrit në muze të ndryshëm. Një aspekt i mirë është se pjesa më e madhe e tyre janë të pajisur me aparate për fikjen e zjarrit, megjithatë, ato nuk janë gjithmonë të vendosura në vende të dukshme dhe ndonjëherë edhe nuk testohen rregullisht (ose jo aq shpesh).

Rekomandimet:

■ Në disa muze janë të domosdoshme më shumë pajisje për mbrojtjen nga zjarri. Qëllim fillestar do të ishte pajisja e të gjithë muzeve edhe me aparate për fikjen e zjarrit, por edhe me sensorë të tymit.

■ Aparatet për fikjen e zjarrit duhet të vendosen në vende të dukshme në të gjithë muzetë. Shenjat e daljes duhet vendosen në muze.

■ Shenjat e daljes duhet të vendosen në muze.

Plani i evakuimit emergjent dhe planifikimi

Ky aspekt është identifikuar si nevojë më urgjente për muzetë e Kosovës. Në të vërtetë, asnjë prej muzeve të vlerësuar nuk ka një udhëzues për procedurën emergjente ose një plan evakuimi.

Rekomandimet:

■ Planet e emergjencës që paraqesin rrugët e evakuimit, daljen më të afërt dhe vendndodhjen e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri (posaçërisht aparatet për fikjen e zjarrit) duhet të vendosen në vende të dukshme në muze.

— Duhet të krijohet një udhëzues për procedurat emergjente, që përfshin të gjithë stafin e muzeut. Ky udhëzues duhet të ofrojë informata themelore rreth roleve të ndryshme të anëtarëve të stafit në rast emergjence dhe hapave themelorë dhe të rëndësishëm ose masave që duhet ndërmarrë në rast zjarri.

Trajnimet

Stafi në muze të ndryshëm është trajnuar rrallë për të evakuuar njerëzit në rast zjarri ose për t'u kujdesur për artefaktet në një situatë të tillë. Zakonisht stafi nuk di as si t'i përdorë aparatet për fikjen e zjarrit, që paraqet një problem sidomos kur aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të vendosura në vende të dukshme. Për më tepër, bashkëpunimi me zjarrfikësit në shumicën e rasteve nuk është krijuar fare. Pritet që do të ketë një koordinim të keq dhe jofunksional në rast zjarri.

Rekomandimet:

— Anëtarët e stafit duhet të trajnohen në mënyrë që të mësojnë se si të veprojnë dhe si të reagojnë në situata emergjente.

— Zjarrfikësit duhet të jetë të vetëdijshëm për specifikat kur është fjala për ballafaqimin me ose fikjen e zjarrit në muze.

— Bashkëpunimi me zjarrfikësit duhet të krijohet për të siguruar një koordinim të mirë në rast zjarri. Për më tepër, duhet krijuar kanale të komunikimit. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta duket të jetë një ide e mirë e aktiviteteve për t'u organizuar.

— Duhet organizuar ushtrime simulimi me qëllim të identifikimit të problemeve eventuale të koordinimit ose drejtimit, me qëllim të përmirësimit të reagimit të stafit ndaj situatave emergjente.

Siguria

Niveli i sigurisë është shumë i ndryshëm prej njërit muze në tjetrin.

Rekomandimet:

— Muzeve që u mungojnë pajisjet e sigurisë duhet të pajisen me sisteme alarmi dhe me kamera për të siguruar një parandalim më të mirë të akteve të dëmshme.

Mirëmbajtja

Të gjitha ndërtesat dhe ambientet e muzeve duket se janë të mirëmbajtura mirë, duke u pastruar rregullisht. Për më tepër, në të gjithë muzetë morëm përgjigje nga personeli se organizohen inspektime të rregullta.

Në disa vende, anëtarët e stafit përmendën se disa kontrole janë organizuar vetëm pas kërkesave të bëra nga stafi (nëse vërejnë ndonjë problem me një dritë që nuk punon, për shembull). Megjithatë, disa defekte elektrike, për shembull, ose probleme me pajisjet e sigurisë nga zjarri (një sensor tymi që nuk funksionon) mund të mos vërehen, nëse nuk kontrollohen për këtë qëllim.

Rekomandim:

— Ngritja e vetëdijes për domosdoshmërinë e kontrollimeve të rregullta të pajisjeve të ndryshme – dhe jo vetëm atëherë kur vihet re një problem.

Koleksionet:

Koleksionet zakonisht janë të etiketuara, dokumentuara dhe janë krijuar inventarizime. Kjo do të thotë se në rast zjarri, do të jetë e lehtë të identifikohen humbjet. Për më tepër, nëse rreziku i humbjes së disa artefakteve nganjëherë mund të jetë i lartë, rreziku i humbjes së informacionit rreth këtyre artefakteve është relativisht i ulët. Megjithatë, inventarët shpesh bëhen vetëm në një format (letër, në internet ose në formate elektronike).

Rekomandimet:

— Duhet krijuar disa kopje rezervë (back-up) të dokumenteve të inventarëve dhe artefakteve (për shembull në letër dhe formate elektronike).

Përfundimi i Raportit

Ky raport ofron një pasqyrë të situatës aktuale në lidhje me mbrojtjen nga rreziku prej zjarrit në muzetë e Kosovës. Falë këtyre vlerësimeve ekziston një pasqyrë më e mirë e asaj se çka nevojitet për të përmirësuar qëndrueshmërinë e muzeve ndaj zjarrit.

Veprimet e synuara për të zvogëluar rrezikun ndaj zjarrit dhe pasojat e tij të mundshme duhet të merren parasysh për të siguruar një mbrojtje më të mirë të koleksioneve. Një nevojë e veçantë është krijimi i planeve të evakuimit dhe organizimi i trajnimeve që përfshijnë të gjithë anëtarët e stafit, si dhe zjarrfikësit.

Një rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre vlerësimeve është se ka rritur ndërgjegjësimin e të intervistuarve. Për më tepër, të intervistuarit kanë reaguar në mënyrë të mirë ndaj pyetjeve që u janë parashtruan atyre, dhe ata dukej se e merrnin parasysh rëndësinë e zbatimit të masave për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose pasojat e tij. Ky reagim dhe vullneti për të përmirësuar situatën ndoshta do të lehtësojnë zbatimin e masave, dhe është një shenjë e mirë për organizimin e trajnimeve, që do të kenë ndikim lidhur me këto çështje.

Referencat

Abolmasov B, Jovanovski M, Feric P, Mihalic S (2011) Humbjet për shkak të tërmeteve historike në rajonin e Ballkanit: Vështrim i përgjithshëm i të dhënave në dispozicion të publikut, Geofizika, Vol 28, 2011, pp. 161-181

Andreoni M. (2018) Zjarri në muze në Brazil "Patjetër do të ndodhte", the New York Times, 4 sept. 2018, <https://www.nytimes.com/2018/09/04/world/americas/brazil-museum-fire.html?action=click&module=RelatedLinks&pgtype=Article>

Arts Council England (2013) Siguria në Muze dhe Galeri: Parandalimi i Zjarreve, udhëzues praktik. URL: http://326gtd123dbk1xdkdm489u1q.wpengine.netdna-cdn.com/wp-content/uploads/2016/11/FirePrevention_02.pdf

ASK (n.d.) Ueb Faqja e Agjencisë së Statistikave të Kosovës: <http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics>

Becker, P. (2014)- Shkenca e Qëndrueshmërisë: Menaxhimi i Rrezikut dhe Qëndrueshmëria për Zhvillim të Qëndrueshëm. Amsterdam dhe Oxford: Elsevier (207 faqe)

Cedergren A., Hassel H. (2018)- Një Kornizë për Vlerësimin e Rrezikut për Planifikimin e Përdorimit të Tokës. Universiteti Lund: Divizioni i menaxhimit të rrezikut dhe siguria shoqërore

CFPA Europe (2013) Menaxhimi i Sigurisë nga Zjarri në Ndërtesat Historike, CFPA-E Guideline No 30:2013 F

Këshilli i Evropës (2015)- Plani Rajonal i Trashëgimisë Qendër – Prishtinë, 2015-2018

EXOVA (n.d.) Siguria nga Zjarri në Ndërtesat Historike

ECA qytetet e qëndrueshme (2012)- Përmirësimi i Efeçencës së Energjisë në Prishtinë, Kosovë. https://esmap.org/sites/esmap.org/files/DocumentLibrary/TRACE_Kosovo_Pristina_Optimized.pdf

Elezaj Z. (2009)- Mjedisi Seizmotektonik i Kosovës. J. Int. Environmental Application and Science, Vol. 4 (2), pp. 167-176

EC MA Ndryshe (n.d.)- Qendra Historike e Prishtinës Numëron Ditët e Fundit, Raport preliminar

Faberi M & Ramadani Q (2014)- Vlerësimi i cenueshmërive aktuale të shëndetit publik për shkak të ndryshimeve klimatike në Kosovë. Projekti i UNDP-së, Mbështetja për Zhvillim me Emetim të Ulët (SLED), i financuar nga Austrian Development Cooperation, 11 dhjetor 2014

Galan, Aparicio (2013)- Vlerësimi i rrezikut mjedisor që zbatohet për trashëgiminë kulturore. Një qasje metodologjike, Built Heritage 2013, Monitoring Conservation Management, pp 1405-1409

Grajçevci, F, Kurteshi H (2012)- Cenueshmëria e ndërtesave ekzistuese në zonat e vjetra urbane të Prishtinës, arsyetimi i ruajtjes historike të zonës. Konferenca e Parë

Ndërkombëtare për Arkitekturën dhe Projektimin Urban

Herscher A, Riedlmayer A (2001)– Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore në Kosovë, 1998–1999: Anketë e pasluftës. Projekti për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës, Cambridge: Massachusetts USA

ICOMOS (2000) ICOMOS– Raporti Botëror 2000 për Monumentet dhe Objektet në Rrezik. I disponueshëm në: https://www.icomos.org/risk/world_report/2000/riskindex_eng.htm

Organizata Ndërkombëtare për Migracion (2014)–Fakte për Vendin: Kosovë, qershor 2014. http://www.bamf.de/SharedDocs/MILo-DB/EN/Rueckkehrfoerderung/Laenderinformationen/Informationsblaetter/cfs_kosovo-dl_en.pdf?__blob=publicationFile

Jigyasu, Rohit, et al. (2013)– Trashëgimia dhe Qëndrueshmëria: Çështjet dhe Mundësitë për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë

Agjencia Kosovare për Menaxhim të Emergjencave (2015)– Strategjia për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020, Republika e Kosovës (Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia për Menaxhim të Emergjencave, Prishtinë 2015

Agjencia Kosovare për Menaxhim të Emergjencave (2016)– Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjtëra, Republika e Kosovës (Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Menaxhim të Emergjencave, Prishtinë, korrik 2016

Kreimer, A., & Arnold, M. (Eds.). (2000)– Menaxhimi i Rrezikut të Fatkeqësive në Ekonomitë në Zhvillim, Banka Botërore

Marjusic, Gülerce, Kuka, Duni, Ivancic, Radovanovic, Glavatovic, Milutinovic et al (2016)– Një katalog i përditësuar dhe unik i tërmeteëve për rajonin e Ballkanit Perëndimor, Buletini i Inxhinierisë së Tërmeteëve, Vol 14, n^o2

McDaniel et al (2002) Kapitulli 9: Siguria dhe Mbrojtja nga Zjarri, Doracak i Muzeut, Pjesa I: Koleksionet e Muzeve, NPS, Washington DC

Muco B, Grecu B, Milutinovic Z, Radulian M (2012)– Vlerësimi i rreziqeve gjeologjike dhe hartat e tyre në disa vende të Ballkanit, Rreziqet Natyrore, nëntor 2012

Mun Yee H (2017) Siguria në qytet, Kosovo 2.0., 2 gusht 2017

OSCE (2014)– Trashëgimia e Paluajtshme e Prekshme në Kosovë, mars 2014

Pedersoli, Antomarchi, Michalski (2016) Një udhëzues për Menaxhimin e Rrezikut të Trashëgimisë Kulturore, ICCROM, Qeveria e Kanadasë, Canadian Conservation Institute

Republika e Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2017)– Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017–2027

Sabbioni, C., Cassar, M., Brimblecombe, P., & Lefevre, R. A. (2009).

Cenueshmëria e trashëgimisë kulturore ndaj ndryshimeve klimatike. Atmosfera e Ndotjes, 202, 157-169.

Siemens (2015)- Mbrojtja nga Zjarri në Ndërtesa Historike dhe Muze, Zvicër

Sugio K. (2015) Fatkeqësitë e shkallës së gjerë mbi trashëgiminë botërore dhe trashëgiminë kulturore në Japoni: Ndikimet e konsiderueshme dhe rastet e menaxhimit të qëndrueshëm, Landscape Research, 40:6, 748-758

Stanton-Geddes, Zuzana, dhe Salman Anees Soz (2017)-Promovimi i Trashëgimisë Kulturore të Qëndrueshme ndaj Fatkeqësive

Stovel, H. (1998) Përgatitja për rreziqet: manual menaxhimi për trashëgiminë kulturore botërore. ICCROM

Tehler H. (2015) Një Kornizë për Vlerësimin e Rrezikut. Universiteti Lund: Divizioni i menaxhimit të rrezikut dhe siguria shoqërore

Aneks: Pyetësi i përdorur gjatë intervistave
Pyetësor për vizita në teren

Vlerësimi i rrezikut nga *zjarri* në ndërtesa të trashëgimisë kulturore

1. Informatat bazike

1 Emri

2 Adresa

3 Data e ndërtimit

4 Lloji i ndërtesës

5 Shfrytëzimi

6 Pronari

7 Lloji i pronësisë

8 Lloji i mbrojtjes

9 Lloji i arkitekturës

10 Madhësia

11 Materiali ndërtimor

2. Informata rreth zonës përreth ndërtesës

Mbledhja e informative të zonës përreth ndërtesës është e rëndësishme me qëllim të vlerësimit të ekspozimit të aseteve të trashëgimisë kulturore nga zjarret që fillojnë jashtë asetit.

	PO	JO
1 A ka aseti "buffer zonë" të definuar?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2 A respektohet ajo?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3 Madhësia e perimetrit/zonës së mbrojtur (nëse ka):		
<input type="text"/>		
4 A është e pastër zona (mbeturina në tokë, etj)?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
5 A ka ndonjë ndërtesë që ndërhyr në aset?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6 A është aseti lehtësisht i qasshëm?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8 A ka ndonjë punë ndërtimore në afërsi të asetit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
7 Afërsia e infrastrukturës (kabllot elektrike, rrugët, etj.)?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8 Përshkrimi i ndërtesave përreth asetit:		
<input type="text"/>		

3. Informacionet lidhur me aktivitetet e mëparshme

1

A ka ndodhur ndonjë zjarr në të kaluarën në ndërtesë?

PO

JO

Nëse po, burimi:

Aksident

Mungesa menaxhimit

Vandalizimi/ malicious act

Nga rrethina

Tjetër

Informata relevante (frekuenca/numri i ngjarjeve paraprake, humbja e vlerave/ artefaktet e prekura, informata rreth reagimit, detaje të tjera rreth ngjarjeve të kaluara, etj.):

4. Menaxhmenti i ndërtësës

1 Si financohet asetit?

PO

JO

2 A ka interes politik (në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e asetit) dhe investim publik?

3 A ka resurse të mjaftueshme njerëzore?

4 A ka resurse të mjaftueshme financiare?

5 Sa është numri i stafit?

6 Si komunikon ekipi/ stafi?

7 A ka instrumente ligjore lidhur me asetin?

Nëse po, të përmenden ato:

8

Informata të tjera relevante:



5. Vlerësimi i cenueshmërisë

1 Materialet ndërtimore: a janë ato veçanërisht të ndeçshme (p.sh. druri)?

PO

JO

Detajet:

2 A ka burime potenciale të ndezjes brenda ndërtesës?

3 A ka punë ndërtimore brenda asetit?

4 A janë marrë masat e mjaftueshme për siguri gjatë punëve rinovuese?

5 Informata relevante që lidhen me shfrytëzueshmërinë e ndërtesave, të cilat mund të jenë të dobishme për rrezikun ndaj zjarrit (praktika të cilat kanë impakt, kufizim apo e rrisin rrezikun ndaj zjarrit):

6. Qasja

1

A është ndërtesa e qasshme nga zjarrfikësit?

PO

JO

2

Cila është gjendja e rrugës, informata, përse ajo ka qasje të lehtë apo të vështirë?

7. Sistemi dhe pajisjet e sigurisë ndaj zjarrit

	PO	JO
1 A ka sensorë të tymit ose nxehtësisë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2 A ka të përdorura materiale rezistuese ndaj zjarrit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3 A ka “sprinklera?”	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4 A ka bombola për fikjen e zjarrit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
5 A ka qasje të lehtë në ujë, apo zallë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6 A është e ndaluar pirja e duhanit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8 A ka hidrantë të ujit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
7 A ka rrufepritës?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8 Sa është distanca e hidrantit më të afërt?		
	<input type="text"/>	
8 Informata të tjera relevante:		
	<input type="text"/>	

8. Plani i evakuimit/ emergjencave

1

A është i trajnuar stafi të përballet me situata emergjente (sikurse ushtrime në rast të zjarrit, etj?)

PO

JO

A janë ata të trajnuar për të evakuuar njerëz?

A janë ata të trajnuar për të evakuuar artefakte?

Sa shpesh organizohen trajnimet?

A ka role të definuara brenda stafit në raste emergjente?

2

A ka ndonjë formë të bashkëpunimit me brigadën e zjarrfikësve?

A merr pjesë brigada e zjarrfikësve në ushtrime simuluese?

A i ka brigada e zjarrfikësve pajisjet dhe njohuritë e nevojshme (për shembull, për të mos shkaktuar dëme anësore nga uji në ndërtesë dhe në komponentë të tij gjatë intervenimit)?

A është e trajnuar brigada e zjarrfikësve për specifikat e ndërtesave historike?

3

A ka rrugë të veçanta në rast të evakuimit?

A janë ato rrugë (qasje lehtësisht të shfrytëzueshme) pa pengesa?

PO JO

A janë të dimensionuara në mënyrë adekuate ato rrugë?

A janë të shënuara qartë ato rrugë (p.sh. a ka shenjë “DALJA”, ose drita emergjente)?

4 A ka ndonjë që tregon qasjen, rrugë evakuimi, hidrantë, etj.?

5 A ka plan të evakuimit?

A ka ndonjë person përgjegjës për zbatimin e planit të evakuimit në rast të emergjencës?

A i specifikon plani kanalet e komunikimit për t'i përdorur në raste emergjente?

A ofron plani detaje të mjaftueshme të evakuimit të njerëzve dhe objekteve apo koleksioneve specifike brenda asetit?

A kanë pronat kulturore specifika për trajtim të veçantë në rast të emergjencave?

A specifikohet qasja në pronë (për zjarrfikës, etj.)?

A është i njoftuar i tërë stafi me planin e evakuimit?

A është i përditësuar plani?

Sa shpesh?

Informata të tjera relevante:

9. Siguria

Kontrollimi i sigurisë është aspekt i rëndësishëm meqë shumë zjarre që shkaktohen në ndërtesa janë zjarrvënie të qëllimshme

1

A është e kontrolluar qasja në aset?

PO

JO

Si?

A ka rojë sigurie?

A ka kamera sigurie në aset?

A ka alarm sigurie gjatë kohës kur aset i është i mbyllur?

Detaje të tjera:

10. Mirëmbajtja

PO JO

1 A ka mungesë të dukshme të mirëmbajtjes (bari jo i prerë, etj.)?

Nëse po, përshkruaj:

2 A janë të testuara pajisjet kundër zjarrit (bombolat)?

Sa shpesh?

3 A ka ventilim natyral apo artificial?

Lloji:

4 A ka gjenerator?

5 A sigurohet që të shkyçen pajisjet elektrike në rastet kur ato nuk përdoren?

6 Lloji i sistemit të ngrohjes

7

A ka inspektime të rregullta të ndërtesës dhe komponentëve të tij)?

PO

JO

Sa shpesh kryhet mirëmbajtja?

Sa shpesh kontrollohet infrastruktura përcjellëse e ndërtesës
(instalimet elektrike, pajisjet etj.)?

Informata të tjera relevante:

11. Koleksionet (për muze)

Mbledhja e informatave lidhur me koleksionet është e rëndësishme, në mënyrë që të kemi një ide rreth dëmtimeve potenciale të cilat mund të lidhen me zjarrin e shkaktuar në muze.

1 A ka inventar të elementeve të ndryshme apo të koleksionit?

PO

JO

2 Sa shpesh e transportoni koleksionin?

3 Si është i organizuar transporti? A merren masat e nevojshme për bartjen e duhur të koleksionit?

4 Si është e organizuar ruajtja?

5 Ku është i ekspozuar koleksioni? A është stabile?


6 A janë të përshkruara/ interpretuara koleksionet?

7 A janë të dokumentuara koleksionet?

Si (letër/dokument, database online, në kompjuter, në disa vende/ back-up)?

7

Detaje të tjera:

A large, empty rounded rectangular box with a thin grey border, intended for providing additional details or information.

